



**STANDARDET E ZHVILLIMIT
DHE TË MËSUARIT NË
FËMIJËRINË E HERSHME
0-6 VJET**



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

STANDARDET E ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT NË FËMIJËRINË E HERSHME

0-6 VJET

TETOR, 2011

Ky publikim është zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, me mbështetjen e UNICEF-it Zyra në Kosovë

prishtina@unicef.org; [www.unicef.org / kosovo](http://www.unicef.org/kosovo)

Fotograf: Samir Karahoda

Dizajn: www.xhad.net

Tetor, 2011

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Hyrje.....	5
Çfarë janë standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet	7
Vlerat dhe parimet e zbatuara gjatë hartimit të SZHMFH	7
Fushat zhvillimore, përcaktimi i moshës dhe grupmoshave të përfshira në SZHMFH.....	9
Kush mund t'i përdorë SZHMFH, për çfarë përdoren dhe për çfarë nuk përdoren SZHMFH	12
Procesi i hartimit të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet [SZHMFH]	13
Sqarimi i termave	15
Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor	17
Gjuha dhe komunikimi	33
Zhvillimi emocional dhe social.....	45
Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme	55
Qasja ndaj të mësuarit	71
Literatura	80

Parathënie

Të nderuar



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ndër prioritetet e saj zhvillimore, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe edukimit në fëmijërinë e hershme. Duke qenë të bindur se kujdesi dhe investimi në këtë moshë dhe në këtë segment të sistemit arsimor, është investim dhe sukses i garantuar në tërë sistemin arsimor, hartimi i dokumentit të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit, është tregues i përpjekjes së vazhdueshme për rritjen e cilësisë në edukimin parashkollor.

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit janë hartuar për të gjithë fëmijët e Republikës së Kosovës, pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, statusit socioekonomik, ndryshimeve kulturore apo aftësive dhe nevojave specifike të tyre. Këto standarde synojnë stimulimin, përkrahjen dhe krijimin e mundësive dhe ambientit sa më nxitës për zhvillimin optimal të fëmijëve dhe të mësuarit e tyre. Duke pasur parasysh karakterin gjithëpërfshirës, konsiderojmë që përmes këtij dokumenti, edukimi i hershëm, tanimë edhe në aspektin përmbajtësor është pjesë përbërëse e sistemit arsimor kosovar.

Përmbajtja e dokumentit ndihmon për të kuptuar sa më mirë gatishmërinë e fëmijëve për t'u zhvilluar dhe për të mësuar. Përmes realizimit të kësaj përmbajtjeje, përmes krijimit të ambientit socioemocional të përshtatshëm, përmes krijimit të kushteve fizike dhe përmbajtësore për zhvillimin e aktiviteteve të shumëllojshme, përmes stimulimit të lojës dhe ndërveprimit të fëmijëve, synohet të rritet edhe më tej cilësia e veprimtarisë edukative pa marrë parasysh se ku realizohet kjo veprimtari, në familje, institucion parashkollor, qendër me bazë në komunitet, qendër të kujdesit ditor apo institucione shkollore.

Këto standarde mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit në fëmijërinë e hershme, pra nga prindërit, kujdestarët, edukatorët, mjekët pediatër, ekspertët e fushave të ndryshme zhvillimore, politikëbërësit dhe implementuesit e politikave arsimore, si dhe aktorët e tjerë që trajtojnë edukimin e hershëm të fëmijëve.

Përdorimi i shumëfishtë i këtyre standardeve, jo vetëm si udhërrëfyes të zhvillimit optimal dhe të mësuarit të fëmijëve, por në të njëjtën kohë edhe si bazë e mirëfilltë për hartimin e kurrikulës, për përmirësimin dhe vlerësimin e programeve që ofrohen në edukimin e hershëm, për përmirësimin e përgatitjes së edukatorëve, për hartimin e programeve për prindër, për monitorimin kombëtar apo për rritjen e vetëdijes dhe njohurive publike për zhvillimin e hershëm, e bëjnë këtë dokument mjaft të rëndësishëm dhe shumë të përdorshëm.

Të bindur që me këtë dokument kemi plotësuar një boshllëk të dokumenteve relevante për edukimin e hershëm, po ashtu shprehim bindjen se implementimi i tij do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së punës me fëmijët, duke i përgatitur ata më së miri për shkollë dhe për jetë.

Prof. Dr. Ramë Buja
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

HYRJE

Kosova ka zhvilluar një qasje të integruar ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme, në të cilën kombinohen shumë natyrshëm procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit, lojës së fëmijëve dhe kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre. Në këtë kontekst për edukimin parashkollor janë hedhur hapa të rëndësishëm si hartimi i Ligjit mbi edukimin parashkollor (2006), hartimi i standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç (2006) dhe kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç (2006).

Kjo qasje gjithëpërfshirëse e edukimit të hershëm, ka zënë vendin e saj mjaft të rëndësishëm edhe në planin strategjik pesëvjeçar 2011-2016, në të cilin Ministria e Arsimit ka përcaktuar qartë qëllimet dhe pritshmëritë për të rritur dhe zhvilluar më tej komponentet përbërëse të këtij edukimit. Kështu, sigurimi që të gjithë fëmijët pa dallim të kenë qasje të barabartë në shërbimet e ofruara, nxitja dhe promovimi i formave alternative për edukimin parashkollor, fokusimi në rritjen dhe kontrollimin e cilësisë së punës edukative me fëmijët dhe rritja e vetëdijes, jo vetëm e prindërve por edhe e vetëdijes kombëtare për rëndësinë e madhe të investimit në fëmijërinë e hershme, zënë një vend të rëndësishëm në këtë plan strategjik.

Dokumenti i hartuar i standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit, pritet të ndikojë në mënyrë mjaft pozitive te të gjithë përdoruesit e tij. Duke pasur në qendër fëmijët dhe i hartuar për fëmijët, ky dokument prezanton arritjet e fëmijëve në periudha të caktuara moshore në fusha të ndryshme zhvillimi, dhe njëkohësisht ofron modele dhe stimuj se si duhen mbështetur dhe inkurajuar fëmijët për t'i arritur këto standarde. Duke marrë në konsideratë që është një dokument që i referohet të gjithë fëmijëve të Kosovës, secili prej nesh mund ta shfrytëzojë atë me qëllimin kryesor mbështetjen e zhvillimit më të mirë të fëmijëve tanë.



ÇFARË JANË STANDARDET E ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT NË FËMIJËRINË E HERSHME 0-6 VJET [SZHMFH]

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme janë formulime që përshkruajnë pritshmëritë për sjelljen e fëmijëve dhe performancën apo arritshmërinë e tyre në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe të mësuarit, duke reflektuar në atë se “*çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët*”. Këto standarde kanë synim kryesor të stimulojnë zhvillimin optimal të fëmijëve pavarësisht gjinisë, karakteristikave individuale, shoqërore, nivelit ekonomik të familjeve të tyre, prirjeve apo nivelit të aftësive. Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, kanë në qendër fëmijën dhe janë hartuar për fëmijët, prandaj plotësimi i tyre duhet konsideruar vetëm si mbështetje për zhvillimin e fëmijëve.

VLERAT DHE PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETEN SZHMFH

Vlerat bazë mbi të cilat mbështeten standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijëri të hershme 0-6 vjet, janë:

Individualiteti. Çdo fëmijë është unik. Dallimet në mes të fëmijëve duhet të njihen, kuptohen dhe respektohen.

Autonomia. Autonomia dhe përgjegjësia e fëmijës duhet të nxiten, respektohen dhe vlerësohen.

Vetëbesimi, koncepti pozitiv mbi veten. Vetëbesimi dhe motivimi i brendshëm i fëmijës e ndihmon atë të ballafaqohet me sukses me sfidat e jetës.

Zhvillimi i tërësishëm i fëmijës. Zhvillim maksimal kualitativ, i mundshëm i të gjitha potencialeve ekzistuese.

Zhvillimi i aftësive komunikuese. Vlerë bazë mbi të cilën më me lehtësi krijohen edhe vlerat e tjera.

Kreativiteti. Çdo fëmijë ka potenciale në vete, andaj është detyrë e të rriturve t’i hetojnë, nxisin dhe zhvillojnë potencialet e fëmijës.

Respekti dhe dashuria ndaj vendit/përkatësia. Çdo individ është qytetar i një vendi e kulture përkatëse, me të cilën duhet të njihet dhe krenohet.

Kompetencë (përgjegjësi) sociale. Si qenie shoqërore çdo fëmijë duhet të njihet me normat shoqërore, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij/saj.

Ndërsa parimet bazë mbi të cilat mbështetet realizimi i përmbajtjes së standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit, janë :



Barazia: Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme janë hartuar për të gjithë fëmijët e Kosovës dhe bazuar në këtë parim, fëmijët trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht dallimeve gjinore, ndryshimeve socioekonomike, përkatësisë fetare, përkatësisë etnike, nevojave të tyre të ndryshme. Barazia gjinore nënkupton përfshirjen dhe trajtimin e barabartë të fëmijëve gjatë realizimit të standardeve pa bërë dallime e diskriminim në baza gjinore (mashkull/femër). Barazia gjinore duhet të reflektohet në raportet në mes fëmijëve, raportet e të tjerëve me fëmijët, realizimin e aktiviteteve, përfshirjen në lojë, inkuadrimit në të mësuar duke inkurajuar fëmijët (vajzë dhe djalë) të kenë lirinë e zgjedhjes, mundësi të barabarta dhe përfshirje të njëjtë. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje në përmbajtjen e dokumentit dhe shërbimet e ofruara në kuadër të këtij dokumenti.

Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijës: Standardet kanë si synim kryesor pikërisht zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijës, i cili ndërtohet në mënyrën më të mirë kur fëmijës i ofrohen mundësi të pafundme zhvillimi. Qasja tërësore e standardeve harmonizohet me zhvillimin tërësor të fëmijëve.

Bashkëpunimi në mes faktorëve edukativë: Realizimi i përbajtjes së dokumentit është i suksesshëm vetëm nëse familja, institucioni parashkollor, shkolla dhe të gjithë aktorët e tjerë lokalë apo qendrorë konsiderohen si pjesë të një tërësie. Bashkëpunimi në mes tyre është një domosdoshmëri, sepse ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

Loja dhe të mësuarit duke ndërvepruar: Loja konsiderohet si një nga instrumentet kryesore që nxit fëmijën për zhvillim. Loja për fëmijën është vetë jeta, rrita dhe gëzimi i tij/saj dhe si e tillë loja duhet nxitur, orientuar, stimuluar dhe mbështetur, sepse vetëm si e tillë e ka kuptimin dhe rëndësinë e vet.

Çdo fëmijë është i gatshëm të mësojë që nga lindja: Stimulimet dhe intervenimet e hershme janë shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme dhe efekti i tyre reflektohet fuqishëm në periudhat e mëvonshme të zhvillimit. Të gjithë fëmijët kanë potencial të arrijnë pjesën më të madhe të standardeve për një moshë të caktuar, sigurisht me stimulim, nxitje, mbështetje dhe udhëzime përkatëse.

Fëmija, pjesëmarrës aktiv: Fëmija zhvillohet dhe mëson më së miri duke u ballafaquar me sfida, në këtë ballafaqim i rrituri është vetëm orientues, i cili nuk pengon iniciativat dhe kreativitetin e fëmijës, përkundrazi i nxit ata vazhdimisht në këtë drejtim duke krijuar një ambient sa më motivues. Sugjerohet që sfidat të jenë spontane dhe sa më të natyrshme pasi të mësuarit buron nga përvoja jetësore e vetë fëmijës.

FUSHAT ZHVILLIMORE, PËRCAKTIMI I MOSHËS DHE GRUPMOSHAVE TË PËRFSHIRA NË SZHMFH

Fëmija zhvillohet si tërësi, pra në të gjitha fushat zhvillimore. Mbivlerësimi apo nënvlerësimi i cilësdo fushë është gabim sepse fëmija nuk zhvillohet njëherë në aspektin fizik, pastaj atë emocional, intelektual etj. Prandaj, edhe ndarja në mes fushave është kryesisht formale. Ashtu si zhvillimi i fëmijës është tërësor edhe fushat e veçanta të zhvillimit duhet të shikohen si pjesë të një tërësie, efikasiteti i të cilave kryesisht varet nga niveli i integritimit në mes tyre. Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në këtë dokument bazë, trajtojnë këto fusha zhvillimi:

- **Shëndeti fizik dhe zhvillimi lëvizor**
- **Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimit**
- **Zhvillimi emocional dhe social**
- **Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme**
- **Zhvillimi i qasjes ndaj të mësuarit**

Çdo pritje dhe e arritur e fëmijëve duhet të ecë në hap me moshën e tij/saj, prandaj edhe përcaktimi i moshës dhe i grupmoshave, sipas të cilave janë prezantuar standardet për t'u realizuar, është një element tjetër tejet i rëndësishëm i këtij dokumenti.

Përcaktimi i moshës:

- 1 vjeç konsiderohet fëmija që është 11 muaj e 29 ditë
- 2 vjeç konsiderohet fëmija që është 23 muaj e 29 ditë
- 3 vjeç konsiderohet fëmija që është 35 muaj e 29 ditë
- 4 vjeç konsiderohet fëmija që është 47 muaj e 29 ditë
- 5 vjeç konsiderohet fëmija që është 59 muaj e 29 ditë
- 6 vjeç konsiderohet fëmija që është 71 muaj e 29 ditë

Përcaktimi i grupmoshave:

Grupmoshat e prezantuara në dokument kanë këtë përcaktim, i cili është bërë duke u mbështetur në legjislacionin e vendit tonë.

- 0-2 vjeç [0-6 muaj; 6-18 muaj; 18-24 muaj]
- 2-3 vjeç
- 3-4 vjeç
- 4-5 vjeç
- 5-6 vjeç

Shumë e rëndësishme për të gjithë përdoruesit e dokumentit, është qartësia në arritjen apo realizimin e standardeve nga fëmijët. Fëmijët mund dhe duhet të tregojnë realizimin e standardeve në tremujorin e fundit të caktit të moshës së përcaktuar, pra realizimi i standardeve për moshën 4 vjeçare, fillon të arrihet në moshën 4 vjeç pa 3 muaj deri në 4 vjeç. Duke qenë një dokument jovlerësues, nëse fëmija nuk e ka arritur treguesin në moshën përkatëse, atëherë prindi, kujdestari apo edukatorja duhet të stimulojnë fëmijën të zhvillojë aktivitetet e moshës paraprake.



KUSH MUND T'I PËRDORË SZHMFH, PËR ÇFARË PËRDOREN DHE PËR ÇFARË NUK PËRDOREN SZHMFH

Standardet krijohen që të rrisin cilësinë e përgjithshme të veprimtarisë edukative me fëmijët. Zhvillimi i standardeve ka rëndësi shumëdimensionale sepse:

- *Na ndihmojnë të sqarojmë çfarë duam të mbërrijmë*
- *Krijojnë një bazë për matje dhe vlerësime të programeve*
- *Mund të prodhojnë më shumë rezultate të drejta, të paanshme*
- *Sigurojnë mundësinë e krijimit të marrëveshjeve*
- *Na ndihmojnë të vendosim rezultate reale të pritshmërisë për fëmijët*
- *Na ndihmojnë të përmirësojmë programet e përgatitjes profesionale për edukatorët*
- *Na ndihmojnë të promovojmë programet e bashkëpunimit me familjen*

Për këto arsye, këto standarde mund të përdoren nga të gjithë individët që janë të interesuar në fëmijërinë e hershme, pra prindër dhe familjarë të tjerë që kujdesen për fëmijë, kujdestarë apo kujdestarë primarë, edukatore, studentë, profesorë dhe ekspertë të fushave të ndryshme zhvillimore, politikëbërës qoftë të nivelit qendror apo atij lokal, organizata implementuese të programeve të ndryshme që rrjedhin nga ky dokument, e të tjerë.

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, mund të përdoren për:

1. Zhvillimin apo rishikimin e kurrikulës parashkollore
2. Përmirësimin dhe vlerësimin e programeve
3. Përfshirjen e familjes në programe
4. Përmirësimin dhe përgatitjen e motrave edukatore dhe edukatoreve parashkollore
5. Monitorimin kombëtar
6. Përmirësimin e instruksioneve
7. Rritjen e vetëdijes dhe njohurive publike për zhvillimin dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, NUK duhet të përdoren:

- *për vlerësimin apo diagnostikimin e fazave të zhvillimit të fëmijëve,*

- *për të vlerësuar cilësinë e punës së ndonjë edukator-i/je,*
- *për të zëvendësuar kurrikulën,*
- *për të mënjanuar nga institucioni apo mospranuar në institucion një fëmijë,*
- *për të krijuar sisteme dënimi apo shpërblimi për fëmijë apo për stafin edukativ.*

PROCESI I HARTIMIT TË STANDARDEVE TË ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT NË FËMIJËRINË E HERSHME 0-6 VJET [SZHMFH]

Procesi i hartimit të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, filloi në vitin 2008 me iniciativën e zyrës së Unicef-it në Prishtinë, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Qëllimi kryesor ishte hartimi i standardeve gjithëpërfshirëse, stimuluese për zhvillimin tërësor të fëmijëve, që do t'i shërbenin të gjithë të interesuarve në fëmijërinë e hershme dhe që do të kishin në qendër fëmijën.

Procesi u realizua në disa faza:

1. Marrja e vendimit për hartimin e standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme.

Në kuadër të kësaj faze, dy ekspertë të fëmijërisë së hershme morën pjesë në punëtoritë orientuese dhe validuese [5 ditore] organizuar nga zyra qendrore e Evropës Juglindore e Unicef . Më pas nga MASHT u krijua grupi i ekspertëve të fëmijërisë së hershme me pjesëmarrës nga shumë sektorë kyç, si dhe prind, të cilët zhvilluan dy punëtori rreth procesit të hartimit të SZHMFH. Punëtoritë janë udhëhequr nga ekspertë ndërkombëtarë.

Në kuadër të këtyre punëtorive, pjesëmarrësit përcaktuan vlerat kyçe dhe parimet bazë të dokumentit, si dhe fushat zhvillimore dhe grupmoshat të cilat do të jenë të përfshira në dokument.

2. Hartimi i draftit të parë të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme

Hartimi i draftit të parë të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme u realizua nga anëtarët ekspertë të grupit punues të cilët të ndarë në grupe të vogla [sipas fushave zhvillimore] realizuan një punë të mirë ekipore dhe me pjesëmarrjen edhe të prindërve, hartuan draftin e parë të dokumentit. Gjatë procesit të hartimit u respektuan rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, si dhe u konsultua një mori e literaturës ndërkombëtare. Drafti i parë i dokumentit u hartua për një periudhë 4 mujore.

3. Ekspertiza ndërkombëtare e draftit të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme

Në këtë fazë, drafti i dokumentit u redaktua nga ana e ekspertëve ndërkombëtarë, si rrjedhim i së cilës u ofruan disa

sugjerime për plotësim dhe përmirësim të dokumentit. Rishikimi i draftit u fokusua në:

- a. qartësimin e vendosjes së standardeve të ngjashme në disa fusha zhvillimore
- b. ndarje në nënfusha të fushës emocionale dhe sociale me qëllim qartësimin e saj
- c. riformulim të disa treguesve me qëllim të vlerësimit të arritshmërisë së tyre
- d. qartësimet në aspektin gjuhësor
- e. konkretizimin sa më të madh të treguesve përmes aktiviteteve të ofruara

Grupi punues mori në konsideratë sugjerimet e dhëna të cilat në shumicën e tyre u përfshinë në dokument.

4. Validimi i standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme

Procesi i validimit të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, është konsideruar si zbatim praktik i konceptit shkencor të zhvillimit të fëmijëve. Për këtë proces është ndjekur metodologjia e rekomanduar nga ekspertët ndërkombëtarë, e përshtatur për kontekstin tonë. Në këtë proces janë angazhuar individë të ndryshëm nga grupi bazë punues. Procesi i validimit ka siguruar sqarimin dhe përsosjen e mëtejme të dokumentit.

Metodologjia e procesit të validimit u realizua në dy faza:

- a- Validimi i përmbajtjes së standardeve** – me të cilën përmes metodologjisë shkencore vlerësohet se a reflektojnë standardet tona përmbajtjen për çfarë fëmijët tanë duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë?

Ky proces u realizua me ekspertë të fushave të ndryshme zhvillimore, si pediatër, psikologë, psikiatër, pedagogë, drejtorë të institucioneve parashkollore, dhe gjithashtu edhe ekonomistë, fiziatër etj. Me këtë grup të ekspertëve u zhvillua një punëtori dy-ditore e moderuar nga këshilltaret rajonale, në të cilën u prezantua dokumenti dhe u kërkua që ekspertët të plotësojnë pyetësozin përkatës. Grupi i dytë pjesëmarrës në validimin e përmbajtjes ishin edukatorët që punojnë me fëmijët nga 9 muaj deri në 6 vjet. Punëtorja e organizuar me motrat dhe edukatorët parashkollore, u përmbyll me plotësimin e pyetësorit të përgatitur për to. Ndërkohë me prindër nga komuna të ndryshme të Kosovës, u organizuan fokus grupe përmes të cilave u morën opinionet e tyre rreth përmbajtjes së dokumentit.

- b- Validimi i moshës** – në të cilin përmes metodologjisë shkencore, u siguruan dëshmitë kuantitative për përputhjen e treguesve me moshën e dhënë, pra të treguesve të cilët manifestojnë atë që fëmija duhet dhe mund ta bëjë në moshë të caktuar.

Gjatë këtij procesi u angazhuan prindër dhe edukatore parashkollore të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes vëzhgimit të rreth 700 fëmijëve, dhe intervistimit të prindërve, siguruan të dhëna mjaft të vlefshme për këtë proces.

Procesi i validimit u realizua për një periudhë kohore prej 14 muaj.

5. Hartimi i versionit përfundimtar të standardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme

Pas rezultateve të marra nga dy proceset e validimit, grupi i punës ka organizuar dy punëtori në të cilat është bërë përfshirja e sugjerimeve dhe rezultateve në draftin përfundimtar të standardeve.

Pas kësaj, me mbështetjen e Unicef-it, përmes konsulentës, dokumenti është shqyrtuar edhe në aspektin e respektimit të barazisë gjinore.

Në këtë mënyrë dokumenti është finalizuar.

SQARIMI I TERMAVE

Në tërë përmbajtjen e tij, dokumenti përcjell domethënien e termave specifike si fushë zhvillimi, nënfushë zhvillimi, standard, tregues dhe aktivitet i të mësuarit.

Fushë zhvillimi:

Fushat zhvillimore janë aspektet e ndryshme të zhvillimit të tërësishëm të fëmijës. Këto fusha duhet të shihen në lidhje të ngushtë reciproke me njëra-tjetrën, pra kushtëzohen dhe kushtëzojnë zhvillimin e tërësishëm të fëmijës. Në dokumentin tonë fushat zhvillimore janë: fusha e shëndetit fizik dhe zhvillimit lëvizor, fusha e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit, fusha e zhvillimit emocional dhe social, fusha e zhvillimit njohës dhe njohurive të përgjithshme dhe fusha e zhvillimit të qasjes ndaj të mësuarit.

Nënfushë zhvillimi:

Nënfushat e zhvillimit konsiderohen si veçanti zhvillimore brenda një fushe zhvillimi. Përmbajtja e nënfushave është e fokusuar vetëm në veçantitë e fushës zhvillimore, kështu për fushën e shëndetit fizik dhe zhvillimit lëvizor, nënfushat zhvillimore janë: zhvillimi i aftësive lëvizore bazike (muskujt e mëdhenj), zhvillimi i aftësive lëvizore fine (muskujt e vegjël), zhvillimi i aftësive senso-lëvizore dhe zhvillimi i shëndetit fizik dhe kujdesit për veten.

Standard:

Standartet janë formulime rreth rezultateve të pritshme për sjelljen e fëmijëve dhe arritshmërinë e tyre në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe të mësuarit duke reflektuar çfarë fëmijët duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë. Këto standarde vendosen për nënfushat e ndryshme zhvillimore dhe janë të njëjta për të gjithë grupmoshën 0-6 vjet.



Tregues:

Janë shumë të lidhur me standardet dhe janë manifestime të dukshme dhe të matshme të veprimeve të fëmijëve. Treguesit janë shembuj konkretë të njohurive apo shkathtësive të fëmijëve dhe vendosen për grupmosha të veçanta (24 muajsh, tre vjeç, katër vjeç etj.) dhe sigurojnë realizimin e standardit përkatës për tërë grupmoshën 0-6 vjet. .

Aktivitet i të mësuarit:

Janë shembuj të aktiviteteve të thjeshta të cilat mund të realizohen nga të gjithë individët që janë afër me fëmijët. Zhvillimi dhe realizimi i tyre, nxit dhe siguron arritjen e treguesit. Shembujt e dhënë në aktivitetet e të mësuarit mund të shërbejnë si udhërrëfyes apo modele edhe për shembuj të tjerë të aktiviteteve që i shërbejnë qëllimit të njëjtë.

SHËNDETI FIZIK DHE ZHVILLIMI LËVIZOR

Zhvillimi fizik dhe lëvizor është një faktor mjaft i rëndësishëm në periudhën e hershme të zhvillimit të fëmijës. Rritja dhe zhvillim i fëmijës janë të vrullshëm sidomos në periudhën e parë të fëmijërisë së hershme, ndërkohë që kjo rritje pëson një rënie gjatë viteve të moshës parashkolllore. Megjithëse përdoren shpesh si terma të njëjtë, rritja dhe zhvillimi nuk kanë të njëjtin kuptim. **Rritja** e fëmijës i referohet ndryshimeve specifike në strukturën trupore, ndryshime që kanë të bëjnë kryesisht me rritjen e peshës apo gjatësisë së fëmijës, rritjen e duarve apo këmbëve etj. Ndërkohë **zhvillimi** i referohet ndryshimeve në nivelin funksional dhe nivelin e kompleksitetit të këtyre ndryshimeve, kompleksitet që ndjek rregullin nga më i thjeshti te më i ndërlikuari. **Zhvillimi fizik** i referohet ndryshimeve në nivelin funksional të strukturave trupore me kalimin e kohës, ndërkohë që, **maturimi** (pjekuria) është e programuar në pikëpamjen gjenetike dhe ndodh natyrshëm me kalimin e kohës, mbi të mjedisi ka një ndikim shumë të vogël. Maturimi është i lidhur ngushtë me rritjen. Zhvillimi fizik dhe lëvizor është mjaft i vrullshëm në tre vjetët e parë të jetës së fëmijës, gjatë të cilave kockat dhe muskujt e fëmijës zhvillohen shumë. Gjithashtu edhe aftësitë e tyre koordinuese, të forcës apo ekuilibrit zhvillohen po kaq vrullshëm, duke bërë që ata të zhvillojnë me energji aktivitetet e tyre ditore. Ndërkohë në moshën 3-6 vjeç, për shkak të forcimit dhe maturimit të sistemit skeletor, trupi i fëmijëve parashkollorë merr një formë më të rregullt, me një pamje atletike, karakteristike për këta fëmijë. Aftësitë lëvizore të tyre bëhen më të rafinuara, lëvizjet janë më të koordinuara dhe aftësitë e ekuilibrit zhvillohen dukshëm. Të gjithë fëmijët hyjnë në periudhën parashkolllore me një bagazh dhe llojshmëri të aftësive lëvizore të cilat i kanë përfituar dhe përsosur gjatë fëmijërisë së hershme të tyre, e në të cilat përfshihen qëndrimi i drejtë ulur, drejtqëndrimi dhe të ecurit. Gjatë viteve të para të jetës, fëmijët përsosin aftësitë e tyre lokomotore (të zhvendosjeve) si dhe aftësitë e tyre manipulative duke u bërë kështu të aftë të gjenden në ambientin e tyre. Me kalimin e kohës fillon të zhvillohet ajo që quhet strukturë e lëvizjeve të përgjithshme, e cila përfshin kërcimet, hedhjet, kapjet, vrapimet tashmë të mësuar.



Rregullsia e zhvillimit fizik dhe lëvizor ndjek dy modele bazë: modeli cefalocaudal (nga koka te këmbët) dhe modeli proksimodistal (nga qendra e trupit drejt ekstremiteteve). Në modelin cefalocaudal zhvillimi ndodh së pari dhe shumë më shpejt te koka sesa në pjesët e poshtme të trupit, ndërkohë në modelin proksimodistal rritja ndodh më herët dhe më shpejt në qendër të trupit sesa në ekstremitete. Një tjetër karakteristikë e zhvillimit është se fëmija zhvillohet prej reagimeve të përgjithshme më pak specifike drejt reagimeve më të kontrolluara specifike, përmes procesit që quhet diferencim.

Zhvillimi fizik dhe lëvizor mbështet zhvillimin edhe në fusha të tjera, si ai social kur fëmija luan dhe bashkëvepron me fëmijë të tjerë, fushën njohëse kur fëmija eksploron jo vetëm objektet, rekuizitat, ambientin, por edhe strukturën e re lëvizore, etj. Procesi i zhvillimit të fëmijës në fushën e zhvillimit fizik dhe lëvizor, është paraqitur më poshtë sipas këtyre nënfushave:

Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike: në të cilën fëmijët fitojnë aftësi për të kontrolluar lëvizjet e trupit të tyre, aftësi të ekuilibrit, të koordinimit të lëvizjeve të tyre [të ecurit, të vrapuarit, të kërcyerit, të hedhurit, ngjitja apo zbritja e shkallëve etj.].

Zhvillimi i aftësive lëvizore fine: në të cilën fëmijët fitojnë aftësi të kontrollit të duarve dhe gishtave, aftësi të koordinimit sy-dorë, dhe aftësi të manipulimit të objekteve të ndryshme të përdorimit ditor [të kapurit, mbërthimi apo zbërthimi i kopsave, lidhëseve të këpucëve, zinxhirëve të veshjeve, të vizatuarit, të shkruarit, krijimi i formave të ndryshme me plastelinë, brumë etj. etj.].

Zhvillimi i aftësive senso-lëvizore: në të cilën fëmijët fitojnë aftësi për të rregulluar dhe perfeksionuar lëvizjet e tyre përmes zhvillimit dhe përdorimit të shqisave.

Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten: në të cilën fëmijët tregojnë shkathtësi në plotësimin e rutinës ditore gjatë veshjes dhe ushqyerjes, aftësi në plotësimin e higjienës personale dhe shmangien e aktiviteteve dhe situatave të rrezikshme apo që mund t'i lëndojnë.

❖ **Nënfusha 1. Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]**

Standardi 1 : Fëmijët tregojnë aftësi të kontrollojnë lëvizjet e trupit

Standardi 2 : Fëmijët tregojnë aftësi të zhvillimit të ekuilibrit

Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit të lëvizjeve të tyre

❖ **Nënfusha 2. Zhvillimi i aftësive lëvizore fine [muskujt e vegjël]**

Standardi 1 : Fëmijët tregojnë aftësi të përdorimit të duarve dhe gishtave

Standardi 2 : Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit sy-dorë

Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi të manipulimit të lodrave apo artikujve të përdorimit ditor

❖ **Nënfusha 3 : Zhvillimi i aftësive senso-lëvizore**

Standardi 1 : Fëmijët përdorin shqisat e tyre për të rregulluar lëvizjet

❖ **Nënfusha 4 : Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten**

Standardi 1 : Fëmijët tregojnë shkathtësi në plotësimin e rutinës ditore gjatë veshjes dhe ushqyerjes

Standardi 2 : Fëmijët tregojnë shkathtësi në plotësimin e higjienës personale

Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi në shmangien e aktiviteteve dhe situatave të rrezikshme apo që mund t'i lëndojnë



Nënfusha 1. Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]
Standardi 1 : Fëmijët tregojnë aftësi të kontrollojnë lëvizjet e trupit

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija lëviz kokën nga një anë në tjetrën kur është i shtrirë në bark</p> <p><i>Tundni një lodër me zhurmë nga vende të ndryshme të dhomës</i></p> <p>Fëmija mbledh dhe shtrin këmbët kur është i shtrirë në shpinë</p> <p>Reagon ndaj gudulisjes [xiglimit] me lëvizje të ndryshme <i>Përkëdheleni dhe guduliseni [xigliseni] fëmijën tuaj duke filluar nga shpina</i></p>	<p>Fëmija rrotullon trupin kur është i ulur për të gjetur objektet pas vetes</p> <p><i>Vendosni objekte pas shpinës së fëmijës dhe bëjani me dije që objektet janë aty</i></p> <p>Fëmija përkulet për të gjetur lodrën nën tavolinë</p> <p><i>Vendosni objekte nën tavolinë dhe kërkoni nga fëmija ti gjejë ato</i></p>	<p>Fëmija ecën drejt objektit apo personit që e thërret</p> <p><i>Organizoni lojëra të ndryshme ku fëmija duhet të ushtrojë të ecurit drejt, brenda në dhomë apo jashtë në natyrë</i></p> <p>Fëmija hipën dhe zbret shkallët duke u mbajtur te mbajtëset e shkallëve</p> <p><i>Lejoni fëmijën t'ju shoqërojë kur hipni apo zbrisni shkallët në shtëpi apo objekt, por gjithmonë mbajeni nën vështrim, ose përdore</i></p>	<p>Fëmija kërcen me të dy këmbët</p> <p><i>Organizoni lojëra të ndryshme në të cilat stimulohet kërcimi me dy këmbë duke kërkuar nga fëmija të imitojë kafshët që kërcëjnë me të dy këmbët si lepur, kangur etj.</i></p> <p>Fëmija vrapon duke ndërruar drejtimin dhe lëvizjes</p> <p><i>Stimuloni fëmijën të vrapojë nëpër oborr drejt caqeve të ndryshme</i></p>	<p>Fëmija hipën dhe zbret shkallët pa u mbajtur në mbajtësen e shkallëve</p> <p><i>Lejoni fëmijën të zbresë dhe të hipë në mënyrë të pavarur shkallët, për të dalë në oborr dhe anasjelltas</i></p>	<p>Fëmija pret, kap një top të madh me të dy duart</p> <p><i>Zhvilloni lojëra të ndryshme që nxisin kapjen, pritjen e topave të mëdhenj</i></p> <p>Percjell kërkesën e të rriturit në përkuljen e trupit, rrotullime apo zgjatje të trupit pa u rrëzuar</p> <p><i>Bashkë me fëmijën zhvilloni përkulje të trupit, rrotullime në vend, zgjatje të krahëve etj.</i></p>	<p>Lëviz me lehtësi rreth pengesave duke anashkaluar ose duke i kapërcyer ato</p> <p><i>Luani bashkë me fëmijën në natyrë apo brenda në dhomë, duke stimuluar dhe zhvilluar lehtësinë në lëvizjet e tij/saj në ambientin përkatës</i></p>

Nënfusha 1. Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]
Standardi 2 : Fëmijët tregojnë aftësi të zhvillimit të ekuilibrit [baraspesha]

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija mban kokën drejt kur e mbani në krahë</p> <p><i>Mbajeni fëmijën në pozitë të drejtë, duke e ndihmuar të mbajë qëndrim të drejtë të kokës</i></p> <p>Fëmija rrotullohet vetë në të dy drejtimet, nga shpina në bark dhe anasjelltas</p> <p><i>Vendoseni fëmijën në pozitë të ndryshme, me shpinë, anash,... dhe stimuloni rrotullimin e tij/saj</i></p>	<p>Fëmija qëndron ulur pa ndihmë, kur e vendosni në karrige apo ulëse të tjera</p> <p><i>Krijoni mundësi dhe pozita të sigurta në të cilat fëmija të ushtrojë qëndrimin ulur</i></p> <p>Ecën nëpër dhomë pa ndihmë</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën t'ju ndjekë nëpër dhomë gjatë veprimeve tuaja</i></p>	<p>Fëmija ecën disa hapa prapa</p> <p><i>Duke u shoqëruar me ritmin e muzikës, kërkoni nga fëmija të bëjë lëvizje para dhe prapa</i></p> <p>Qëndron mbi gishta kur dëshiron të mbërrijë një lodër</p> <p><i>Bashkë me fëmijën imitoni mbledhjen e frutave, apo lëkundjen e duarve në ajër</i></p>	<p>Fëmija ndjek një vijë të vizatuar në dysheme</p> <p><i>Vizatoni në dysheme vija në formë të ndryshme dhe bashkë me fëmijën ecni nëpër to</i></p> <p>Fëmija ulet dhe ngrihet me lehtësi nga karrigia [ulësja]</p> <p><i>Organizoni lojëra si brenda dhomës, objektit apo edhe jashtë në natyrë, në të cilat fëmija stimulohet të ulet apo të ngrihet nga karrigia apo ulëset e oborrit</i></p>	<p>Në pozitën ulur dhe pa u rëzuar, fëmija e sjell topin rreth vetes</p> <p><i>Afroni fëmijës topa të madhësive të ndryshme dhe stimulojini t'i sjellin rreth vetes pa u rëzuar</i></p> <p>Fëmija qëndron mbi një këmbë deri në 5 sekonda</p> <p><i>Organizoni lojëra në të cilat fëmija do të ushtrojë qëndrimin mbi një këmbë [numëroni deri në5]</i></p>	<p>Qëndron mbi një këmbë për dhjetë sekonda ose më tepër</p> <p><i>Nën tingujt e muzikës bashkë me fëmijën bëni lëvizje të trupit duke bërë pushime të vogla apo qëndrime mbi një këmbë</i></p> <p>Fëmija ecën brenda vijës të drejtë të hollë [2-3 cm] duke ruajtur ekuilibrin e trupit</p> <p><i>Stimuloni fëmijën të ecë nëpër vija, si p.sh. vijën që krijojnë ndarjet e pllakave</i></p>	<p>Fëmija kapërcen me lehtësi mbi objekte të ulëta [deri 20 cm]</p> <p><i>Të shpërndara në dhomë apo jashtë në natyrë, vendosni objekte të vogla të sigurta me lartësi 20 cm dhe inkurajoni fëmijën t'i kapërcejë ato</i></p> <p>Fëmija kërcen me një këmbë pa e humbur ekuilibrin</p> <p><i>Bashkë me fëmijën luani dhe kërceni me një këmbë</i></p>

Nënfusha 1. Zhvillimi i aftësive lëvizore bazike [muskujt e mëdhenj]
Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit të lëvizjeve të tyre

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija lëviz kokën në të gjitha drejtimet, duke iu përgjigjur ngacmuesve[tingullit, dritës, prekjës etj.]</p> <p><i>Këndoni dhe bisedoni me fëmijën duke lëvizur ju nëpër dhomë</i></p> <p>Mund të qëndrojë ulur pa mbështetje për pak sekonda</p> <p><i>Provoni ta vendosni fëmijën në pozitë ulur duke e mbikëqyrur vazhdimisht</i></p>	<p>Ngrihet nga pozita ulur në këmbë dhe anasjelltas</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të praktikojë ngritjen nga pozita ulur duke i afuar lodrën që dëshiron, apo duke e thirrur në emër</i></p> <p>Ecën drejt tavolinës apo këndit të tij/saj të lojës</p> <p><i>Krijoni mundësinë që të lëvizë me lirshmëri në dhomë apo jashtë në natyrë</i></p>	<p>Fëmija hipën dhe zbrit shkallët duke qëndruar me të dy këmbët në një shkallë</p> <p><i>Lejoni fëmijën por edhe ndihmoni atë në ngjitjen e shkallëve</i></p>	<p>Fëmija gjuan topin me të dy duart</p> <p><i>Organizoni lojëra në të cilat fëmija duhet të gjuajë topin me të dy duart</i></p> <p>Hipën në krevat dhe zbrit prej tij pa ndihmë</p> <p><i>Lejoni fëmijën të hipë dhe të zbrësë nga krevati, por mbikëqyreni</i></p>	<p>Fëmija e hedh topin në drejtimin e duhur</p> <p><i>Vendosni disa shporta në formë katrore apo rrethi dhe luani me fëmijën duke e hedhur topin në cakun e kërkuar</i></p> <p>Ulet dhe ngrihet [cuc] mbi gjunjët e tij/saj, duke e mbajtur trupin drejt</p> <p><i>Sipas muzikës dhe shembullit të edukatores, prindit, fëmija (djalë dhe vajzë) përfshihet në aktivitete lëvizore të cilat fokusohen në ulje ngritje</i></p>	<p>Fëmija vrapon sipas ritmit të dhënë, më shpejt, më ngadalë...</p> <p><i>Duke dëgjuar ritmin e muzikës fëmija zbaton udhëzimet e edukatores, prindit për të vrapuar sipas ritmit</i></p> <p>Fëmija lëviz pedalet e biçikletës në anën e kundërt</p> <p><i>Krijoni mundësi që fëmija të ngasë biçikletën para, drejt dhe prapa ose të luajnë në dyshe duke lëvizur këmbët me ritmin e biçikletës</i></p>	<p>Fëmija kërcen me lehtësi në sipërfaqe të vizatuara</p> <p><i>Vizatojmë në dyshe forma të ndryshme dhe kërkojmë nga fëmija të kërcëjë sipas renditjes që ju kemi bërë formave Afrojuni fëmijëve mundësinë të provojnë të kërcëjnë me litar [individual ose dy fëmijë tundin litarin, i treti kërcen]</i></p> <p>Fëmija merr pozicione të përshtatshme për të imituar diçka apo dikë</p> <p><i>Kërkoni nga fëmijët të imitojnë mënyrën e të kërcyerit apo të ecurit të një të afërmi apo të një kafshe</i></p>

**Nënfusha 2. Zhvillimi i aftësive lëvizore fine [muskujt e vegjël]
Standardi 1 : Fëmijët tregojnë aftësi të përdorimit të duarve dhe gishtave**

0 - 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija kap, mban dhe pastaj e lëshon një lodër</p> <p><i>Afroni fëmijës lodra të përshtatshme të (buta, të sigurt) duke krijuar mundësinë që t'i kapë ato</i></p>	<p>Fëmija shkarravit forma të ndryshme në letër</p> <p><i>Lejoni fëmijën të shkruajë, shkarravitë me lapsa të përshtatshëm për moshën, çfarë të dojë në letrat që ju i afroni</i></p> <p>Fëmija pi ujë vetë nga gota plastike [edhe duke e derdhur ndonjëherë nga pak...]</p> <p><i>Afroni fëmijës gota apo objekte të tjera prej plastikës, dhe udhëzoheni t'i përdorë ato</i></p> <p>Shtrydh sfungjerin e lagur dhe kënaqet me ujin</p> <p><i>Gjatë larjes lejoni fëmijën të lahet vetë me sfungjerin e tij/saj dhe ta shtrydhë herë pas here</i></p>	<p>Fëmija ndan dhe bashkon lodra të thjeshta të mëdha</p> <p><i>Afroni lodra të përbëra dhe inkurajoni fëmijën të bëjë ndarjen e tyre, duke i shpjeguar edhe mundësinë e bashkimit të tyre</i></p> <p>Kthen faqet e librit, revistës</p> <p><i>Gjatë leximit kërko nga fëmija të kthejë vetë faqen e librit</i></p>	<p>Hap dhe mbyll sirtarët e dollapit</p> <p><i>Lejoni fëmijën të marrë vetë rrobat ose sendet nga sirtarët</i></p> <p>Hap apo mbyll kapakun e shishes, kapakun e kutisë etj.</p> <p><i>Afroni fëmijës shishen dhe kërkonin nga ai/ ajo ta hapë dhe ta mbyllë kapakun. [shishenkutinë]</i></p>	<p>Përdor forma të gatshme për të ndarë brumin e ëmbëlsirës, pites, plastelinës, baltës, [rreth, katror, zemër etj.]</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) që të ndajë forma të ndryshme gjatë përgatitjes së ëmbëlsirave, baltës</i></p> <p>Përdor kapëset e rrobave për të vendosur vizatimet në litar apo imiton që po i var rrobat</p> <p><i>Siguroni kapëse plastike dhe inkurajoni përdorimin e tyre</i></p>	<p>Mbërthen apo zbërthen kopsat, pullat apo zinxhirin e veshjeve [palltos] të tij/saj</p> <p><i>Inkurajoni që fëmija të vishet apo zhvishet vetë dhe të mbërthejë kopsat apo zinxhirin e veshjeve të tij/saj</i></p> <p>Vendos me lehtësi kapakët e kutive të vogla kinder –vezë, kuti të bizhuterive të kukullave apo lodrave të tjera, kutitë e makinave]</p> <p><i>Ruani kutitë e vogla dhe kërkonin nga fëmija t'i mbyllë ato</i></p>	<p>Përdor ngjitësin për të bashkuar pjesë të së njëjtës figurë</p> <p><i>Zgjidhni figura që duhet të bashkohen, dhe udhëzoheni fëmijën të bëjë bashkimin e tyre, apo lejoni t'i bashkojë si të dëshirojë ai/ajo vetë</i></p> <p>Fëmija mban gërrshërë plastike me njërin dorë dhe pret letrën sipas formës së vizatuar [katror, rreth, etj.]</p> <p><i>Kërkonin nga fëmija të presë letrën në të cilën ju keni vizatuar formën</i></p>

**Nënfusha 2. Zhvillimi i aftësive lëvizore fine [muskujt e vegjël]
Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi të koordinimit sy-dorë**

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija kap gishtat e prindërve apo kujdestarëve</p> <p><i>Qëndroni afër me fëmijën dhe luani me duart e tij/saj</i></p> <p>Fëmija zgjat duart drejt objektit që i ofrohet</p> <p><i>Afroni fëmijës lodra që kanë ngjyra të buta, që lëshojnë tinguj të kënaqshëm, apo që kanë forma të përshtatshme për ta, duke stimuluar kapjen e tyre</i></p>	<p>Përplas duart e tij/saj me njëra-tjetrën</p> <p><i>Stimuloni fëmijën të përplasë duart e tij/saj gjatë lojërave të ndryshme</i></p> <p>Vendos 3-4 blloqe [ose objekte të përshtatshme] njërin mbi tjetrin dhe pastaj i rrëzon</p> <p><i>Afroni blloqe ose objekte të sigurt me të cilat fëmija luan dhe luani bashkë me të duke i vendosur ato njëra mbi tjetrën</i></p>	<p>Fëmija mbush dhe derdh gotën me ujë, kovën me rërë, objektet nga një shportë në shportën tjetër etj...</p> <p><i>Lejoni dhe inkurajoni fëmijën të luajë me çdo material të padëmshëm për të, si brenda në dhomë apo sallë, ashtu edhe jashtë në natyrë</i></p> <p>Fëmija kthen faqen e librit, revistës me një dorë</p> <p><i>Gjatë leximit të një tregimi për fëmijë, kërkoni që faqet e tregimit t'i kthejë vetë fëmija</i></p>	<p>Ndërton një kala me 8-10 blloqe</p> <p><i>Kërkoni nga fëmija (djalë dhe vajzë) të ndërtojë me blloqe ose objekte të tjera atë që i pëlqen më shumë</i></p> <p>Heq dhe vendos disa herë një pjesë të enigmës [formuese], deri sa ta gjejë vendin e saktë</p> <p><i>Afroni fëmijës lodra [puzle] të cilat kërkojnë krijimin e një figure, objekti [shtëpi, pemë, lule, etj]</i></p>	<p>Bën varg me rruaza të mëdha, makarona me vrime, rathë të vegjël etj.</p> <p><i>Ofroni fëmijëve mjete të ndryshme të sigurt dhe kërkoni nga ata/ato të bëjnë vargje</i></p> <p>Krijoni figura të ndryshme të përbëra [me format e dhëna]</p> <p><i>Afroni fëmijës figura të përbëra [pjesë-pjesë], shpërbëjini në prani të tyre dhe krijoni sërish figurën. Duke udhëzuar fëmijën inkurajoni ta bëjë këtë në mënyrë të pavarur</i></p> <p><i>Shpërndani jashtë në oborr pjesët përbërëse të një lodre të madhe (prej plastike, bukëpeshku, letre me ngjyrë etj.etj.) dhe kërkoni nga fëmija t'i gjejë dhe të krijojë lodrën e plotë</i></p>	<p>Fëmija pret me gërshërë figura të dhëna sipas formave</p> <p><i>Pasi të ketë bërë një vizatim [shtëpinë, kafshën] kërkoni të presë me gërshërë vizatimin dhe bashkë me të ngjiteni në një vend që i pëlqen fëmijës</i></p>	<p>Përdor materiale të ndryshme [copa tekstili, ngjitës letër, fije lëmshi etj.] për të krijuar figura të ndryshme si aeroplan, shtëpi, karrige, kukulla etj.</p> <p><i>Ofroni materiale të sigurt, mundësi dhe hapësirë ku fëmija mund të punojë mbi idenë e tij/saj * Bashkë me fëmijën krijoni figura të tilla por kujdesuni që punën më të madhe ta bëjë vetë fëmija</i></p>

Nënfusha 2. Zhvillimi i aftësive lëvizore fine [muskujt e vegjël]

Standardi 4 : Fëmijët tregojnë aftësi të manovrimit të lodrave apo artikujve të përdorimit ditor

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Përplas lodrat me njëra-tjetrën</p> <p><i>Afroni fëmijës lodra të buta, të sigurta, të zhurmshme dhe lehtësisht të manipulueshme nga ai/ajo dhe stimuloni t'i përplasë me njëra-tjetrën</i></p>	<p>Kalon një lodër nga njëra dorë te tjetra</p> <p><i>Afroni fëmijës lodra dhe kërkoni nga ai/ajo t'i çojë nga një dorë te tjetra</i></p> <p>Fëmija mbledh gjëra/sendë të përshtatshme [luga, gota plastike, lodra të vogla] me gishtin e madh dhe me gishtin tregues</p> <p><i>Lejoni fëmijën duke e mbikëqyr, të kapë gjëra apo sende me gishtin e madh me atë tregues</i></p>	<p>Ndihmon në mbledhjen e lodrave dhe futjen e tyre në shportë</p> <p><i>Pas përfundimit të lojës, bashkë me fëmijën mblidhni dhe sistemoni lodrat e tij/saj ose kërkoni nga ai/ajo ta bëjë këtë vetë</i></p> <p>Vendos gjësende në vendin e caktuar (frutat në frutierë), pjatën, bukën etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) t'ju ndihmojë në vendosjen e frutave në pjatën e tyre</i></p> <p>Pastron lodrat të papastra</p> <p><i>Stimuloni fëmijën të pastrojë lodrat e tij/saj [me ujë, me peshqir të vogël të lagur, letra të lagura etj.]</i></p>	<p>Fëmija mban kutinë me një dorë e me tjetrën e mbush me sende më të vogla</p> <p><i>Afroni fëmijës një shportë të vogël ose kuti dhe kërkoni nga ai/ajo ta mbushë me sende-lodra të vogla</i></p> <p>Ngjit me njëra-tjetrën pjesë të letrës me ngjyrë për të bërë një varg zbukurues</p> <p><i>Stimuloni fëmijët të bëjnë vetë vargje me letër zbukuruese</i></p>	<p>Mbush vetë shishen me ujë</p> <p><i>Lejoni dhe stimuloni fëmijën të përpiqet të mbushë vetë shishen me ujë, qumësht, lëng etj.</i></p>	<p>Kreh vetë flokët e tij/saj</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të kujdeset vetë për flokët e tij/saj</i></p>	<p>Fëmija mund të lidhë vetë lidhëset e këpucëve</p> <p><i>Lejojini fëmijën të mbathë dhe të lidhë vetë këpucët, atletet</i></p>

Nënfusha 3 : Zhvillimi i aftësive senso-lëvizore
Standardi 1 : Fëmijët përdorin shqisat për të rregulluar lëvizjet e tyre

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Ndjek me sy objektet që janë në lëvizje lart e poshtë, majtas djathtas</p> <p><i>Tundni një lodër me zhurmë para fëmijës dhe lëvizeni atë në drejtime të ndryshme</i></p> <p><i>Thirreni me zë të ëmbël fëmijën tuaj në emër duke lëvizur nëpër dhomë</i></p>	<p>Ecën drejt një objekti me ngjyrë apo formë të caktuar</p> <p><i>Duke i treguar një objekt (kukulla, topa, kuba etj.), kërkoni nga fëmija ta marrë atë</i></p>	<p>Reagon me mimikë dhe lëvizje gjatë rutinës ditore, në shenjë pëlqimi apo mospëlqimi</p> <p><i>Gjatë larjes së dhëmbëve me ndihmë, kushtojini kujdes reagimit të fëmijës ndaj pastës së dhëmbëve apo fortësisë së furçës</i></p> <p><i>Ofroni fëmijëve ushqime që i pëlqejnë</i></p>	<p>Përshtat lëvizjet me ritmin e muzikës</p> <p><i>Nën tingujt e muzikës, udhëzoni fëmijën të bëjë lëvizje sipas ritmit</i></p>	<p>Imiton lëvizjet ose emocionet e personave të tjerë ose kafshëve të ndryshme</p> <p><i>Lexoni ose tregoni një tregim me kafshë duke imituar zërin dhe lëvizjet e tyre, dhe duke kërkuar që edhe fëmija ta imitojë atë</i></p>	<p>Ngjyros brenda vijave</p> <p><i>Afroni fleta vizatimi me figura të zbrazëta dhe kërkoni nga fëmija t'i ngjyrosë</i></p>	<p>Vizatoni me saktësi figura të ndryshme</p> <p><i>Pas një tregimi, kërkoni nga fëmija të vizatojë përfytyrimin mbi personazhin e tregimit</i></p> <p>Zhvillon me lehtësi lojëra lëvizore, duke iu përshtatur kushteve atmosferike dhe udhëzimeve të dhëna të lojës</p> <p><i>Lejoni fëmijët të luajnë jashtë në natyrë, në borë, në shi, në rërë në kushte të ndryshme atmosferike, dhe jepuni udhëzimet përkatëse</i></p>



Nënfusha 4 – Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten

Standardi 1 – Fëmijët tregojnë shkathësi në plotësimin e rutinës ditore gjatë veshjes dhe ushqyerjes

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija reagon ndaj ushqimit kur është i/e uritur [gjirin, shishen me qumësht, pjatën me ushqim]</p> <p><i>Ushqeni fëmijën me gji apo ushqim tjetër çdo herë që tregon shenja urie</i></p>	<p>Provon të vë kapelën në kokë kur del jashtë</p> <p><i>Lejoni fëmijën të vë vetë kapelën kur del jashtë</i></p> <p>Përdor lugën, edhe pse mund ta derdhë pak ushqimin</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përdorë lugën kur ha</i></p>	<p>Vishet me pak ndihmë nga të rriturit</p> <p><i>Lejoni fëmijën të provojë të vishet vetë dhe ndihmoni nga pak</i></p>	<p>Ndihmon në përgatitjen e tavolinës për ushqim</p> <p><i>Lejoni fëmijën (djalin dhe vajzën) që t'ju ndihmojë në përgatitjen e tavolinës për ushqim duke bartur gjëra të sigurt [pecetat, lugët, shportën e bukës]. Stimuloni të dy (djalin dhe vajzën) të marrin pjesë në punë të njëjta</i></p> <p>Fëmija përdor lugën dhe pirunin kur ushqehet</p> <p><i>Gjatë shujtave, afroni fëmijës lugën dhe pirunin e përshtatshëm. Lejoni fëmijën të vetushqehet duke përdorur lugën dhe pirunin</i></p> <p><i>Gjithmonë vendose lugën dhe pirunin afër pjatës së fëmijës</i></p>	<p>Lyen [përhapin] marmelatën, aerokremin mbi bukë me lugë</p> <p><i>Lejoni fëmijën (djale dhe vajzë) të përhapë vetë marmelatën, aerokremin mbi fetën e bukës</i></p>	<p>Derdh qumështin apo lëngun nga shishja në gotë</p> <p><i>Gjatë shujtave, lejo fëmijën të zbrazë jogurtin, qumështin apo lëngun nga një shishe më e madhe në gotë</i></p>	<p>Fëmija vishet vetë</p> <p><i>Lejoni fëmijët të vishen dhe zhvishen vetë</i></p> <p>Fëmija merr pjesë në përgatitjen e ushqimit (ëmbëlsirave)</p> <p><i>Ftojoni fëmijën (djale dhe vajzë) kur përgatisni ushqimin, kur bëni brumin e ëmbëlsirave, pites etj.</i></p>

Nënfusha 4 – Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten
Standardi 2 – Fëmijët tregojnë shkathtësi në plotësimin e higjienës personale

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>I pëlqen dhe relaksohet kur bën banjë [kur pastrohet]</p> <p><i>Derisa lahen (në banjë, banjë të improvizuar) lejo fëmijën të luajë me ujë duke mbajtur me kujdes</i></p>	<p>Tregon pakënaqësi kur pelena është e lagur apo e papastër</p> <p><i>Stimuloni fëmijën t’ju tregojë kur e ka pelenën të papastër</i></p>	<p>Fëmija e mbulon gojën kur kollitet</p> <p><i>Gjatë kollitjes ose teshitjes, rikujtojeni fëmijën të mbulojë gojën me dorë dhe të përdorë shaminë (pecetën e letrës)</i></p> <p>Lan duart me ndihmë</p> <p><i>Lejoni fëmijën të lajë duart para se të hajë, mësoni fëmijët që gjithmonë të lajnë duart para se të hanë dhe shkojnë në tualet</i></p>	<p>Fëmija e përdor brushën e dhëmbëve [të përshtatshme me moshën]</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën të kujdeset për shëndetin e gojës duke përdorur brushën dhe pastën [e përshtatshme] e dhëmbëve</i></p> <p>Përdor tualetin [banjën], plotëson nevojat e tij/saj me pak ndihmë</p> <p><i>Lejoni fëmijën të shkojë vetë në banjë dhe ndihmoni kur ka nevojë</i></p>	<p>Fëmija i lan duart vetë para dhe pas ushqimit</p> <p><i>Përkujtoni fëmijën t’i lajë duart para dhe pas buke dhe bisedoni me të për rëndësinë e kësaj çështjeje</i></p> <p>Fshin vetë hundët kur ka nevojë</p> <p><i>Përkujtoni dhe stimuloni fëmijën t’i fshijë vetë hundët kur ka nevojë</i></p>	<p>Fëmija i kryen nevojat ditore, duke u kujdesur për rregullat e pastërtisë (fshihet, lëshon ujin, lan duart)</p> <p><i>Lejo fëmijën të kujdeset vetë për nevojat ditore [tregoni kujdes të veçantë kur fëmija është i/e sëmurë, me barkqitje, temperaturë etj.]</i></p>	<p>Fëmija pa ndihmë kujdeset për higjienën e trupit</p> <p><i>Përkujtoni fëmijën për rregullat themelore të higjienës, larjen e duarve, fytyrës, dhëmbëve, veshëve për çdo mëngjes dhe kurdo që është e nevojshme. Lejoni fëmijën të lahet duke i shpjeguar atij/asaj rëndësinë e larjes së trupit e posaçërisht disa pjesëve të tij</i></p> <p>Fëmija pa ndihmë shpëlan gojën dhe buzët pas ushqimit</p> <p><i>Nxitni dhe përcillen fëmijën për të shpëlarë gojën dhe buzët pas çdo ushqimi</i></p>



Nënfusha 4 – Shëndeti fizik dhe kujdesi për veten

Standardi 3 : Fëmijët tregojnë aftësi në shmangien e aktiviteteve dhe situatave të rrezikshme apo që mund t'i lëndojnë

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija qan, shqetësohet gjatë rritjes së përnjëhershme të zhurmës</p> <p><i>Afrohuni te fëmija duke u përpjekur ta qetësoni</i></p>	<p>Fëmija ndalon ndaj kërkesës – ndalesës nga i rrituri, në situata të rrezikshme</p> <p><i>Shpjegoni në mënyrë të qartë dhe të saktë ndalesën për materiale dhe situata të rrezikshme (p.sh. shpjegoni fëmijës se me atë mund ta djegë dorën, sepse është shumë e nxehtë)</i></p>	<p>Fëmija e njuh rrezikun e nxehtësisë [nuk i prek sendet e nxehta]</p> <p><i>Flisni me fëmijën për rrezikun e mundshëm nëse luan me burimin e nxehtësisë (shkrepëse, hekurin, stufa e ndezur)</i></p>	<p>Fëmija e kap të rriturin për dore, kur do të shmangë situatat e rrezikshme [shkallë, rrugë, etj.]</p> <p><i>Derisa jeni duke ecur me fëmijën në rrugë, mbajeni për dore dhe shpjegoni rregullat e sigurisë në rrugë. Shpjegoni edhe për sigurinë në shtëpi, shkallët, ballkonit etj.</i></p>	<p>Fëmija i tregon të rriturit nëse ka dhimbje ose ndonjë shqetësim / gjendje tjetër shqetësuese</p> <p><i>Flisni me fëmijën për shenjat kryesore të sëmundjes (dhimbja, kollitja) dhe shpjegoni se pse është me rëndësi t'ju lajmërojë menjëherë nëse ka diçka të tillë</i></p>	<p>Fëmija i shmanget rrezikut në rrugë</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën të shmangë rreziqet e mundshme në rrugë...</i></p> <p>Fëmija e kupton domethënien (kuptimin) e dritave të semaforit në trafik</p> <p><i>Shpjegoni kuptimin dhe rëndësinë e dritave të semaforit dhe ushtroni me fëmijën çdo herë që kaloni rrugën së bashku</i></p>	<p>Fëmija i njuh dhe i dallon veprimet me rreziqe të mundshme</p> <p><i>Përdorni fotografi dhe libra me ilustrime nga përditshmëria ose ngjarje për të treguar sjelljen e rrezikshme (pirjen e duhanit, alkoolit, vozitjen e biçikletës pa helmetë, etj.) dhe bisedoni me fëmijën për këto veti të këqija</i></p> <p>Kërkon ndihmë në rast rreziku [thërret prindin në telefon, numrin 112 në raste emergjence, etj.]</p> <p><i>Ushtroni bashkë me fëmijën dhe inkurajoni në përdorimin e numrit tuaj, apo e numrit të emergjencave 112</i></p> <p>Fëmija e kalon rrugën me kujdes, duke shikuar në të dy drejtimet [me prindin]</p> <p><i>Derisa e kaloni rrugën, mësojeni fëmijën që me kujdes të shikojë në të dy anët e rrugës, që të kalojë rrugën i/e sigurt.</i></p>



ZHVILLIMI I GJUHËS DHE KOMUNIKIMIT

Përvetësimi i gjuhës dhe formave të saj komunikuese gjithmonë paraqet një proces të komplikuar dhe mjaft të rëndësishëm për njeriun. Janë një mori faktorësh që ndikojnë, por edhe kushtëzojnë, në mënyra të ndryshme, zhvillimin, përvetësimin dhe të kuptuarit e drejtë të gjuhës dhe komunikimit.

Përvetësimi i gjuhës dhe përdorimi i drejtë i saj është me rëndësi të jashtëzakonshme për komunikim të suksesshëm, përgjithësisht të çdo individi, e në veçanti për fëmijën e porsalindur, përkatësisht për fëmijën e moshës 0 - 6 vjeç. Ky proces fillon me ardhjen në jetë të fëmijës, i cili menjëherë është i gatshëm të komunikojë në forma të ndryshme si me nxjerrje të zërit, me gjestikulacione e më vonë me të folur gojor si parakushte për përvetësimin e formave të tjera më të përparuara si është leximi dhe shkrimi.

Në zhvillimin e komunikimit dhe gjuhës ndikon edhe komunikimi në shtëpi dhe në shoqëri që në të shumtën e rasteve është jo i barabartë nga aspekti gjinor (mashkull/femër). Fëmijët imitojnë dhe i bartin këto modele të komunikimit në ambiente të ndryshme prandaj realizimi i këtij standardi duhet t'i kushtojë rëndësi trajtimit dhe inkuadrimit të barabartë të të dy gjinive së fëmijës (djalë dhe vajzë).

Rëndësia dhe pesha e fushës, gjuha dhe komunikimi është e veçantë dhe specifike sepse ajo në këtë rast, pos që është fushë më vete është edhe gjuhë e fushave të tjera. Realizimi i suksesshëm i individit, të moshës 0-6 dhe jo vetëm të tij/saj, në këtë fushë varet prej mënyrave të zbatimit në praktikë të këtyre aktiviteteve, përkatësisht nënfushave komunikuese: të dëgjuarit, të folurit gojor, të folurit me anë të mimikës, të lexuarit dhe të shkruarit.

Këto standarde ndikojnë në zhvillimin e tërësishëm e kompleks të personalitetit të fëmijës e sidomos :

- në zhvillimin e aftësive të dëgjuarit aktiv dhe të kuptuarit e asaj që dëgjon,
- në zhvillimin e aftësive të të folurit individual dhe grupor,
- në zhvillimin e aftësive të të folurit mimetik (të folurit përmes mimikës),
- në zhvillimin e aftësive komunikuese brenda grupit dhe me të rriturit
- në lirinë e komunikimit dhe të shprehurit të fëmijës pa dallim gjinor
- në dallimin e përdorimit të gjuhës së folur lokale dhe gjuhës standarde,
- në përvetësimin e drejtë elementar të strukturës së gjuhës standarde,
- në zhvillimin e ndjenjës për tekste letrare e joletrare,
- në përvetësimin e formave fillestare të "leximit",
- në përvetësimin e qëndrimit dhe lëvizjeve (trup, gishtërinj, dorë, laps etj.) në hapësirën e kufizuar,
- në përvetësimin e formave fillestare të "shkrimit",

Këto dhe të tjera gjëra që lidhen me fushën e gjuhës dhe komunikimit janë tregues që garantojnë formimin e një individi aktiv, ndërveprues, të përgjegjshëm e të shkathët me aftësi gjuhësore e që janë përcaktuese edhe për realizimin e fushave të tjera të arsimit parashkollor.

❖ Nënfisha 1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Standardi 1: Fëmija tregon aftësi të tërheqë të rriturin në komunikim përmes kontaktit të syve dhe gjuhës së trupit

Standardi 2: Fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar kur të tjerët flasin

Standardi 3: Fëmija tregon aftësi për të folur dhe komunikuar

Standardi 4: Fëmija manifeston aftësi kreative gjuhësore (shprehëse, me fjalë)

❖ Nënfisha 2. Baza fillestare e të lexuarit

Standardi 1: Fëmija zhvillon aftësi njohëse me format e shkronjave të alfabetit

Standardi 2: Fëmija e kupton rëndësinë e të lexuarit

❖ Nënfisha 3. Baza fillestare e të shkruarit

Standardi 1: Fëmija shfaq aftësi për të shkruar simbole të ndryshme

Standardi 2: Fëmija shfaq aftësi për ta kuptuar qëllimin e të shkruarit

Nënfusha 1 : Të dëgjuarit dhe të folurit

Standardi 1 : Fëmija tregon aftësi të tërheqë të rriturin në komunikim përmes kontaktit të syve dhe gjuhës së trupit

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija lëshon zëra për të tërhequr vëmendjen e të rriturve</p> <p><i>Përgjigjuni zërave të fëmijës duke treguar vëmendje</i></p>	<p>Drejton dorën dhe bën me shenjë për t'i treguar të rriturit se çka do</p> <p><i>Përgjigjuni fëmijës sa herë që bën me shenjë, shprehni gatishmërinë tuaj për të bashkëvepruar me të</i></p>	<p>Fëmija përdor gjestet për të treguar diçka p.sh. macja ra bam</p> <p><i>Tregoni interesim dhe vëmendje kur fëmija u tregon ndonjë ndodhi, duke e shprehur atë edhe përmes lëvizjeve të trupit. Nxitni fëmijën të përshkruajë me gjeste ndonjë ngjarje ose situatë</i></p>	<p>Fëmija luan role gjatë lojës (p.sh. ai/ajo bëhet si aeroplani, treni, etj.)</p> <p><i>Kërko nga fëmija (djalë dhe vajzë) që të luajë role të ndryshme, lavdërojeni mënyrën se si ai/ajo i imiton gjërat.</i></p> <p><i>Mundohuni që edhe ju të imitoni gjëra bashkë me fëmijën tuaj, kjo e nxit kreativitetin e fëmijës dhe ndikon në afërsinë mes njëri-tjetrit</i></p>	<p>1. Fëmija shoqëron të folurit me gjeste dhe mimikë p.sh. kur hidhërohet përplas këmbët, ndërsa kur është i/e lumtur, këndon ose vallëzon.</p> <p><i>Bëni të qartë fëmijës se po e kuptoni. Shprehni këtë me fjalë, por edhe duke përdorur gjestet dhe mimikën</i></p>	<p>Fëmija flet përmes kontaktit me sy dhe gjuhës së trupit</p> <p><i>(bën lajka, bashkon duart dhe lutet, ngreh zërin, etj.) Bisedoni me fëmijën se jo gjithmonë mund ti realizohen kërkesat. Tregohuni të durueshëm për ta dëgjuar fëmijën deri në fund</i></p>	<p>Fëmija përdor në mënyrë harmonike fjalët me gjestet (p.sh. kur reciton një vjershë dhe përmend fluturën ai/ajo hap krahët dhe bën sikur fluturon)</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të tregojë përralla, ngjarje të tjera ose recitojë duke shoqëruar fjalët me gjeste.</i></p> <p><i>Nxitni fëmijën t'ju tregojë gjëra të ndryshme që i ka përjetuar gjatë ditës</i></p>

Nënfusha 1 : Të dëgjuarit dhe të folurit

Standardi 2 : Fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar gjuhën e folur

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija kthen kokën në drejtim të zërit apo tingullit</p> <p><i>Flisni fëmijës edhe kur jeni larg tij/saj, në mënyrë që përmes shqisës së të dëgjuarit ta përcaktojë vendndodhjen tuaj. Po ashtu flisni me fëmijën tuaj gjatë kohës kur jeni duke e ushqyer, ndërruar, veshur, apo mbajtur në prehër.</i></p> <p><i>ejoni të tjerët të komunikojnë me fëmijën.</i></p>	<p>Fëmija përplas duart dhe lëshon tinguj, kur të tjerët e thërrasin në emër</p> <p><i>Flisni me fëmijën duke e thirrur atë në emër.</i></p> <p>Fëmija mund t'i kuptojë shprehjet e thjeshta si p.sh. jo nuk bën, të lumtë etj.</p> <p><i>Komunikoni me fëmijën duke e përdorur drejt gjuhën e folur</i></p> <p><i>Nxisni aktivitetet e fëmijës duke i dhënë lëvdata për aftësitë që tregon.</i></p>	<p>Fëmija i lidh sendet e caktuara me fjalë</p> <p><i>Nxitni fëmijën t'ju tregojë vendndodhjen e gjërave të ndryshme (p.sh. Ku është hëna, ku janë lodrat, etj.)</i></p>	<p>Fëmija i përgjigjet kërkesës për të bërë ndonjë veprim, p.sh. vendose librin në dollap</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të vendosë lodrat, librat, rrobat etj. në vendin e tyre dhe falënderoni pasi ta ketë bërë veprimin e kërkuar.</i></p> <p>Fëmija dëgjon kur i tregohet një përrallë e shkurtër apo histori</p> <p><i>Lexoni përralla të shkurtra të konkretizuara me një interpretim përmes objekteve të ndryshme të përshtatshme për përrallën dhe moshën e fëmijës.</i></p>	<p>Fëmija bën pyetje rreth gjërave që i interesojnë</p> <p><i>Bisedoni dhe tregoni fëmijës për gjëra të ndryshme, dhe nxitni atë për të bërë pyetje</i></p>	<p>Fëmija përdor fjalë përshëndetëse, mirëdita, mirupafshim, etj.</p> <p><i>Përdorni fjalët përshëndetëse me fëmijën p.sh. mirëmëngjesi, natën e mirë etj.</i></p> <p>Gjatë bisedës fëmija pret radhën për të thënë atë që do</p> <p><i>Luani lojëra ku fëmijës i duhet të presë radhën (p.sh. luani ngjarje ku fëmijës i duhet të marrë pjesë sipas rolit)</i></p>	<p>Fëmija mund të ritregojë me fjalët e tij/saj një tregim apo ndonjë ngjarje</p> <p><i>Mundësoja fëmijës të komunikojë me shokë dhe shoqe dhe me të rritur për të treguar ato që di.</i></p>



Nënfusha 1 : Të dëgjuarit dhe të folurit
Standardi 3: Fëmija tregon aftësi për të folur dhe komunikuar

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija lëshon tinguj (zëra) gjatë aktivitetit ditor</p> <p><i>Përgjigjuni me buzëqeshje fëmijës, kur ai/ajo shikon dhe nxjerr zëra.</i></p> <p>Fëmija gugatë dhe përdor tinguj</p> <p><i>2. Foli dhe buzëqeshi fëmijës kur ai gugatë a belbëzon</i></p>	<p>Fëmija shqipton rrokjet ba-ba ma-ma disa herë</p> <p><i>Dëgjoni me vëmendje fëmijën kur të shqiptojë tinguj. Nxitni për shqiptimin që po e bën duke i thënë: " Të lumtë "</i></p> <p>Fëmija mund të përdorë fjalë të thjeshta (nëna, babai, gjyshja etj.)</p> <p><i>Në çdo kohë foli fëmijës dhe ndihmoje atë të shqiptojë drejt fjalët.</i></p>	<p>Fëmija përdor fjali të thjeshta (të cilat jo gjithmonë i shqipton drejt)</p> <p><i>Nxisni bashkëbisedim me fëmijën duke përdorur fjalët në mënyrë të drejtë, duke mos e shtrembëruar fjalorin në atë të "gjuhës së foshnjave" (p.sh. dora, e jo dola).</i></p> <p><i>Bëjeni shprehi që t'i lexoni ose rrëfeni tregime fëmijës, çdo herë para se të fle.</i></p>	<p>Fëmija mund të përdorë fjali mohuese p.sh: jo gjumi</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të shprehet lirshëm.</i></p> <p>Fëmija fillon të përdorë shumësin, por jo në mënyrë të drejtë p.sh. nuk thotë qentë, por qenat</p> <p><i>Nxitni fëmijën tuaj që ta përdorë shumësin e emrave në mënyrë të drejtë.</i></p> <p>Fëmija fillon të flasë me vetveten, sikur të jetë duke folur me një fëmijë tjetër.</p> <p><i>Mos e pengoni fëmijën në kohën kur flet me vetveten, bisedat e tilla janë të dobishme për rritje dhe zhvillim.</i></p>	<p>Fëmija imiton të folurit e të rriturve</p> <p><i>Tregohuni të vëmendshëm për atë që flisni përpara fëmijës.</i></p> <p>Fëmija mund t'i përshkruajë aktivitetet shtëpiake</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që t'ju shoqërojë gjatë punëve të shtëpisë pa i dalluar punët e djalit dhe vajzës. Kërkoni nga të dy që t'ju ndihmojë në punë të lehta dhe kështu fillon t'i mësojë emrat e gjërave.</i></p>	<p>Fëmija tregon rregullat e lojës që do t'i zhvillojnë me të tjerët</p> <p><i>Organizoni aktivitete, ku fëmija merr pjesë aktive përmes komunikimit</i></p> <p>Fëmija përdor intonacion të ndryshëm zëri, kur tregon diçka</p> <p><i>Kërkoni nga fëmija juaj që t'ju rrëfejë ndonjë histori. Tregoni vëmendje në të dëgjuar.</i></p>	<p>Fëmija tregon qartë për një ndodhi ku ka marrë pjesë [ditëlindje, të gjyshja etj.]</p> <p><i>Organizoni aktivitete ku e vënë në shprehje përshkrimin e situatave të mbajtura në mend.</i></p> <p>Të folurit e fëmijës është shumë me i saktë, p.sh. mami kur mund të shkojmë te gjyshja?</p> <p><i>Nxitni fëmijën të bashkëbisedojë me ju.</i></p>

Nënfusha 1. Të dëgjuarit dhe të folurit

Standardi 4 : Fëmija shpreh aftësi kreative gjuhësore (shprehëse me fjalë)

2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
<p>Fëmija pyet për kuptimin e fjalëve të caktuara ose si quhet ndonjë send</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën tuaj që përmes përgjigjeve të mësojë fjalë të reja dhe kuptimin e tyre.</i></p>	<p>Fëmija bashkëbisedon me moshatarët e vet, gjatë lojës</p> <p><i>Mundësoni fëmijës takimin me moshatarë të vet</i></p> <p>Fëmija i përgjigjet pyetjeve që ia bëjnë të rriturit ose moshatarët</p> <p><i>Pyesni fëmijën në mënyrë të vazhdueshme për çdo gjë që bën.</i></p> <p><i>Mundohuni që pyetjet që ia bëni fëmijës të jenë të hapura (përgjigjja e të cilave nuk është PO ose JO), kjo do ta ndihmojë fëmijën që të mendojë për atë që e thotë, në mënyrë kritike.</i></p>	<p>Fëmija mund të krijojë nga imagjinata e tij/saj 3-4 vargje të shkurtra</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën në aktivitete të tilla (p.sh. kur dëshiron të thotë një vjershë edhe kur ajo nuk ka kuptim)</i></p> <p>Fëmija këndon një këngë me tekstin që bën vetë</p> <p><i>Ofroni fëmijës (vajzë dhe djalë) mundësinë të dëgjojë muzikë dhe ta këndojë tekstin e këngës nga imagjinata e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija thur përralla të ndryshme që kanë përmbajtje të strukturuar mirë, dhe me një përfundim të lumtur</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën tuaj t'ju tregojë ngjarje dhe ndihmoni me pyetje, rrëfimin e tregimit.</i></p> <p>Fëmija gjen përgjigje në gjëgjëza, të cilat i dëgjon nga të tjerët</p> <p><i>Tregoni fëmijës gjëgjëza dhe nxitni ata që të përgjigjen</i></p> <p>Fëmija është në gjendje të thurë një tregim në bazë të ilustrimeve dhe muzikës së dëgjuar</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të tregojë rreth asaj që ka përjetuar gjatë ditës.</i></p>



Nënfusha 2 : Baza fillestare e të lexuarit

Standardi 1 : Fëmija tregon interes në materialet e shtypura

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18muaj	18 deri në 24muaj				
<p>Fëmija fokuson vështrimin në një pikturë apo figurë të varur në mur, fotografi, etj.</p> <p><i>Ofroni fëmijës mundësinë që fëmija të shikojë materiale me ngjyra (ilustrime, piktura, fotografi, etj.)</i></p>	<p>Fëmija shikon kapakun me ilustrime të librit apo revistës</p> <p><i>Ofroni fëmijës libra të ndryshëm me figura dhe ngjyra të ndryshme</i></p> <p>Fëmija tregon me gisht fotografi të ndryshme që i pëlqejnë çdo herë që ne e pyesim</p> <p><i>Shfletoni libra me fëmijën, duke kërkuar nga ta që t'i shqiptojnë emrat apo veprimet e figurave të librit.</i></p>	<p>Fëmija shikon figurat, vizatimet në libra dhe materiale të tjera të shtypura</p> <p><i>Ofroni fëmijës materiale të ndryshme të shtypura dhe shfletoni ato bashkë me të</i></p>	<p>Fëmija tregon në libër se ku është teksti, e ku është fotografia</p> <p><i>Kërkoni nga fëmija që të përpiqet t'i japë kuptim me fjalë asaj që e shikon në ilustrime</i></p>	<p>Fëmija shtiret se "lexon" vetë librin</p> <p><i>Lexoni bashkë me fëmijën librin, revistën ose ndonjë tekst tjetër në filmat që i pëlqejnë</i></p>	<p>Fëmija tenton të lexojë librin duke kthyer drejt faqet e tij</p> <p><i>Ofroni fëmijës libra me figura që ata i dëshirojnë dhe lexoni atij/asaj tregimin e zgjedhur</i></p>	<p>Fëmija e di se libri ka titullin, autorin, ka tekst dhe ilustrime</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën për t'i treguar se librin e krijon autori, librat mund të jenë me ilustrime, fotografi, por ka dhe të tilla që janë vetëm me tekst</i></p>

Nënfusha 2 : Baza fillestare e të lexuarit
Standardi 2 : Fëmija e kupton rëndësinë e të lexuarit

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
	<p>Fëmija shfaq dëshirën për të dëgjuar të rriturin, kur i lexon emra të ndryshëm të kafshëve në ilustrime</p> <p><i>Lexoni drejt dhe ngadalë emra të shkurtër që mund t'i gjeni nëpër librat e ilustruar.</i></p> <p>Fëmija tregon me fjalë disa figura në librin e ilustruar <i>Inkurajoni fëmijën tuaj që të përsërisë emrin që ju e lexoni.</i></p>	<p>Fëmija ka dëshirë që ta dëgjojë leximin e ndonjë tregimi të shkurtër nga i rrituri</p> <p><i>Bëni shprehi, që se paku një herë në ditë t'ua lexoni nga një gjë të vogël dhe interesante fëmijës sidomos para gjumit.</i></p>	<p>Fëmija shfaq interesim që ta dëgjojë shumë herë leximin e të njëjtit tregim nga i rrituri</p> <p><i>Tregohuni çdo herë të gatshëm që t'ia lexoni tregimin e preferuar fëmijës suaj, qoftë edhe nëse e keni lexuar disa herë.</i></p> <p><i>Lexojani tregimin e njëjtë fëmijës, me po aq interes sikurse e keni lexuar herën e parë.</i></p>	<p>Fëmija mund ta shpjegojë vetë përmbajtjen e përrallave që ia lexon i rrituri</p> <p><i>Lexoni përralla të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, sa herë që keni mundësi apo e kërkon fëmija juaj.</i></p>	<p>Fëmija mund të bëjë dallimin e numrave dhe shkronjave në tekst</p> <p><i>Vendosni numra dhe shkronja të ndryshme përpara fëmijëve dhe krijoni një lojë me të, ku fëmija mund t'i dallojë simbolet e numrave dhe shkronjave.</i></p> <p><i>Nxitni fëmijën që në tekste të ndryshme të dallojë shkronjat dhe numrat.</i></p>	<p>Fëmija shfaq prirje për të lexuar dhe përcjellë me vëmendje të rriturin gjatë leximit</p> <p><i>Nxitni fëmijën që ta zgjedhë një libër dhe kërkonte që t'ju flasë për ilustrimet që janë paraqitur aty.</i></p> <p><i>Mos e pengoni fëmijën kur është duke u bërë kinse po lexon.</i></p>

Nënfusha 3 : Baza fillestare e të shkruarit**Standardi 1 : Fëmija shfaq aftësi për të shkruar simbole dhe shenja të ndryshme**

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24muaj				
	<p>Fëmija shkarravit kudo</p> <p><i>Ofroni fëmijës një kënd ku ai/ajo mund të bëjë shkarravitjet e ndryshme</i></p>	<p>Fëmija shkarravit në fletë dhe ua tregon të tjerëve</p> <p><i>Ofroni fleta të bardha, ose tabela të vogla për të vizatuar</i></p>	<p>Fëmija vizaton viza të shtrembëruara dhe rrethore</p> <p><i>Krijoni forma dhe jepni mundësi fëmijës që t'i vizatojë ato</i></p>	<p>Kopjon diçka që i pëlqen një formë të dhënë (p.sh. një figurë ose ndonjë shenjë tjetër)</p> <p><i>Vizatoni një formë të thjeshtë dhe nxitni fëmijën ta kopjojë formën</i></p>	<p>Fëmija shkruan ose vizaton forma të ndryshme</p> <p><i>Ofroni fëmijës mundësi dhe materiale të ndryshme për të shkruar ose vizatuar gjëra të ndryshme të mjedisit që e rrethon</i></p>	<p>Fëmija mund të shkruajë simbolet e numrave apo të shkronjave të emrit të vet</p> <p><i>Nxitni fëmijën të numërojë dhe të shkruajë simbolet e numrave që ai/ajo i di</i></p>

Nënfusha 3 : Baza fillestare e të shkruarit
Standardi 2 : Fëmija kupton qëllimin e të shkruarit

0 deri në 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18muaj	18 deri në 24 muaj				
		<p>Fëmija shkarravit me ngjyra dhe lapsa të ndryshëm</p> <p><i>Jepni fëmijës lapsa që kanë trashësi më të madhe, fëmija në këtë moshë shkarravit duke e kapur lapsin me tërë dorën.</i></p>	<p>Fëmija mund të shkarravisë me laps në fletë duke u paraqitur se është duke shkruar</p> <p><i>Çmoni punën e fëmijës që e bën me laps dhe fletë, jepni komplimente për atë çka ka bërë.</i></p> <p>Fëmija ka dëshirë që të ketë ndonjë fletore ose fletë që mund të konsiderohen të tij/saj</p> <p><i>Ofroni fëmijës mundësi për ta pasur një fletë apo fletore. Këtë mund ta bëni së bashku me të duke i grumbulluar disa fletë të pastra dhe duke i kapur me kapëse.</i></p>	<p>Fëmija mund të kuptojë se pjesa e shkruar tregon diçka</p> <p><i>Sa herë që i lexoni fëmijës, mundohuni që t'ia tregoni rëndësinë e kuptimit, duke e komentuar së bashku me të.</i></p> <p>Fëmija kërkon nga i rrituri t'i tregojë se çfarë shkruan afër një ilustrimi, fotografie</p> <p><i>Përgjigjuni pozitivisht kërkesës së fëmijës</i></p>	<p>Fëmija shkruan një simbol të dhënë duke e kopjuar</p> <p><i>Ofroni fëmijës materiale me simbole të ndryshme të cilat mund t'i shkruajnë në letër.</i></p> <p>Fëmija mund të vizatojë gjëra që i pëlqejnë</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të vizatojë lodrën, kafshën apo gjëra të tjera që e rrethojnë</i></p>	<p>Fëmija e kupton rëndësinë që emri i tij/saj të vendoset në punimet që i bën ai/ajo</p> <p><i>Tregoni interesim dhe lavdërojeni çdo herë mënyrën se si fëmija e shënon emrin e tij/saj.</i></p> <p><i>Nxitni fëmijën që t'i dallojë punimet e tij/saj nga punimi i vëllait, motrës, shokut, etj.) përmes shënimit me emër ose ndonjë shenjë tjetër sipas dëshirës.</i></p> <p>Fëmija pretendon se shkruan letër për baba dimrin, gjyshen, etj.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të shkruajë letër për dikë që është larg, ose të bëjë një listë me dëshirat që ka për Vitin e Ri, etj.</i></p>



ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL

Zhvillimi social dhe emocional i fëmijës është një fushë e veçantë e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme e cila së bashku me fushat e tjera të zhvillimit luan rol të rëndësishëm në procesin e formimit të personalitetit të fëmijës dhe të përgatitjes së tij/saj për procesin e shkollimit. Zhvillimi social dhe emocional i fëmijës zhvillon vetëdijen për identitetin personal dhe rrit përgjegjësinë për veten dhe të tjerët.

Zhvillimi social ka të bëjë me aspektin si fëmija ndërvepron me personat e tjerë (prindërit, kujdestarët parësorë, edukatorët, familjarët, moshatarët dhe të rriturit e tjerë) dhe si ndërveprimet me personat e tjerë ndikojnë në zhvillimin e tij/saj. Zhvillimi social i ndihmon fëmijës të njohë mjedisin social që e rrethon, mjedisin kulturor dhe traditën, si dhe të zhvillojë kuptimin për komunitetin. Sjellja e hershme sociale ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga praktikrat e prindërve për rritjen e fëmijëve, duke përfshirë mënyrën se si prindërit realizojnë zbatimin e rregullave, si japin ndihmën dhe nxitjen fëmijës së tyre.

Zhvillimi emocional ka të bëjë me aspektin si ndjehet fëmija për vetveten dhe për botën që e rrethon, si i shpreh ndjenjat, emocionet ndaj vetes dhe të tjerëve. Po ashtu përmes zhvillimit emocional të fëmijës bëhet rritja dhe edukimi i ndjenjës së besimit, miqësisë dhe bashkëpunimit. Zhvillimi i emocioneve ndikohet nga mjedisi shoqëror dhe mënyra se si njerëzit i përgjigjen atyre.

Ndërveprimi i mirëfilltë i këtyre dy aspekteve të zhvillimit rezulton me kompetencën sociale dhe emocionale të fëmijës që manifestohet përmes aftësisë për të krijuar relacione të afërta dhe të sigurta me moshatarët e të rriturit duke i përjetuar, njohur, kuptuar, shprehur dhe kontrolluar emocionet e veta dhe të tjerëve përreth tyre. Meqë këto dy aspekte apo nënfusha - zhvillimi social dhe zhvillimi emocional janë shumë ngushtë të lidhura dhe të ndërvarura nga njëra-tjetra, në këtë dokument janë paraqitur si një fushë e integruar, e ndarë në dy nënfusha: nënfusha sociale dhe nënfusha emocionale. Integrimi përmbajtësor dhe praktik i kësaj fushe bëhet edhe përmes standardeve më të përgjithësuara, përmes indikatorëve dhe aktiviteteve që e konkretizojnë këtë ndërvarësi.

Stereotipet gjinore¹ ndikojnë në masë të madhe në zhvillim emocional e social të fëmijës (djalë dhe vajzë) prandaj për një realizim të plotë e përmbajtësor të përmbajtjes së kësaj fushe duhet kushtuar vëmendje të veçantë gjithëpërfshirëse të fëmijëve. Aktivitetet në vijim do të duhej të realizohen me një ndjeshmëri të madhe ndaj dallimeve gjinore në harmoni me moshën e fëmijës. Duhet pasur parasysh se kompetenca sociale e fëmijës ndikohet në radhë të parë nga temperamentit individual i fëmijës, por edhe nga përjetimet jetësore të tij/saj dhe nga interaksioni i fëmijës me moshatarët, prindërit dhe të afërmit e tjerë.

Pse duhet të përkrahet zhvillimi social e emocional i fëmijës?

¹ **Stereotipet gjinore:** Janë përgjithësimet e thjeshta për qëndrimet, rolet, bindjet dhe dallimet në mes të individëve ose/dhe grupeve (djalë, vajzë; mashkull, femër; motër, vëlla) të cilat janë të përcaktuara nga aspekti shoqëror. Stereotipet, edhe pse portretizojnë këto dallime si shoqërore, për femrat rrallëherë japin informata të sakta meqë bazohen në ndarje/diferencim tradicional e kulturor.

Kur fëmijët ndjehen mirë për veten dhe zhvillojnë relacione pozitive me të tjerët përreth, ata do të jenë në gjendje të përjetojnë, kuptojnë, njohin dhe shprehin emocionet duke qenë të aftë edhe t'i kontrollojnë ato. Përmes një zhvillimi të duhur social e emocional fëmijët kanë gjasa që:

- Të jenë më të suksesshëm në situata grupore, në shkollë dhe në komunitet
- Të jenë më të koncentruar në mësim
- Të komunikojnë ndjenjat e tyre në mënyrë më efektive
- Të ndihen mirë dhe lirshëm, pavarësisht gjinisë
- Të kenë vetëbesim dhe ta çmojnë veten
- Të jenë të aftë për të krijuar lidhje të forta emocionale me të tjerët

Është me rëndësi të theksohet posaçërisht atashimi² si një formë specifike e lidhjes së fortë emocionale të fëmijës me personin kryesor të rëndësishëm në jetën e tij/saj, zakonisht prindin (nënë) ose kujdestarin kryesor. Kjo lidhje speciale i mundëson fëmijës të ndjehet i sigurt, të zhvillojë ndjenjën për besim, por fëmija gradualisht zhvillon edhe aftësinë për t'u ndier dhe për të vepruar si i pavarur. Kujdesi maksimal i prindit/kujdestarit që ta menaxhojë mirë këtë lidhje duke e inkurajuar fëmijën për interaksione edhe me të afërmit e tjerë, e sidomos me moshatarët, përbëjnë bazën e një zhvillimi social dhe emocional të shëndoshë të fëmijës.

Vetë rregullimi (kontrollimi) i emocioneve nënkupton aftësinë e fëmijës që t'i kontrollojë emocionet dhe impulset e tij/saj e sidomos kur ndërvepron me të tjerët. Kjo aftësi ndikohet nga cilësia e atashimit dhe nga niveli i përgjithshëm i zhvillimit të tij/saj. Fëmijët në fazën e foshnjërisë kanë më shumë nevojë për të rriturit që t'u ndihmojnë atyre për të përballuar emocionet e fuqishme, kurse në moshë më të rritur ata mësojnë të kontrollojnë veten. Në moshën parashkollore ata arrijnë të vetëdijesohen për emocionet e tyre dhe i kuptojnë edhe emocionet e të tjerëve përreth tyre.

Nënfusha -Zhvillimi social me të cilin fëmija ndërvepron me moshatarët dhe të rriturit, konkretizohet nëpërmjet standardeve vijuese:

Standardi 1: Fëmija mund të bëjë dallimin mes personave të njohur dhe të panjohur

Standardi 2. Fëmija mund të ndërveprojë me personat përreth (të rritur dhe fëmijë të tjerë).

Nënfusha -Zhvillimi emocional me të cilin fëmija zhvillon konceptin pozitiv për veten dhe për emocionet e tij/saj konkretizohet nëpërmjet standardeve vijuese:

Standardi 1. Fëmija demonstroi se njeh konceptin për veten

Standardi 2. Fëmija përjeton, njeh dhe shpreh në mënyrë të drejtë emocionet

Standardi 3. Fëmija mund të manifestojë aftësi të vetrregullimit të emocioneve

² Atashimi është procesi në të cilin individi shfaq sjellje që ndihmon për të vendosur afërsinë ose kontaktin me një person specifik. Pettijon, Terry F. (1996): Psikologjia. Një hyrje koncize. (Bot.II).Lilo. fq. 82. Cituar nga Ainsworth M.D.S., 1979.

Nënfusha – Zhvillimi social

Standardi 1: Fëmija mund të bëjë dallimin mes personave të njohur dhe të panjohur

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija fillon të njoh dhe kërkojë personat e afërt, si babanë nënën apo kujdestarin kryesor, përmes përplasjeve të duarve, lëshimit të tingujve, etj.</p> <p><i>Përgjigjuni kërkesave të fëmijës duke qëndruar pranë tij/saj, duke i folur, buzëqeshur, ledhatuar etj.</i></p> <p>Fëmija pushon së qari kur i afrohet personi i njohur (nëna, babai, kujdestari)</p> <p><i>Përgjigjuni në mënyrë përkatëse nevojës së fëmijës, merreni në përfaqim kur qanë, krijoni mjedis të përshtatshëm në mënyrë që fëmija të ndjehet i/e sigurt.</i></p>	<p>Fëmija kur sheh dhe dëgjon zërin e personit të njohur reagon me buzëqeshje, zgjatje të duarve dhe me të ecur drejt personit të njohur.</p> <p><i>Përgjigjuni reagimeve të fëmijës duke i folur, buzëqeshur, ecur drejt tij/saj dhe duke luajtur së bashku me të.</i></p> <p>Fëmija rri pranë personit të njohur në një mjedis të panjohur (e kapë për dore, kërkon ta mbajë në krahë etj.).</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën paraprakisht për mjedisin në të cilin do të shkoni. Në mjedis të panjohur, kapeni fëmijën për dore dhe i qëndroni afër.</i></p>	<p>Fëmija vëzhgon dhe imiton veprimet e personave të afërm (shtiret sikur lexon apo shkruan si person i rritur, etj.).</p> <p><i>Lejoni fëmijën t'ju shoqërojë kur lexoni, vizatoni, shkruani apo kur kryeni ndonjë aktivitet ditor në shtëpi.</i></p> <p>Fëmija është i afërt me pjesëtarët e familjes.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të miqësohet me persona të afërm dhe bisedoni me fëmijën si të sillet me anëtarë të afërm të familjes.</i></p>	<p>Fëmija fillon ndërveprimin me personin e njohur përmes lojës dhe aktiviteteve ditore.</p> <p><i>Krijoni mundësi fëmijës t'ju njohë më mirë. Qëndroni afër fëmijës derisa luan me lodra, luani së bashku me të, afroni gjërat që i duhen.</i></p> <p>Fëmija rri me anëtarë të familjes dhe preferon të luajë me ta (p.sh. thërret: nënë ttë lutem eja luaj me mua, gjysh, hallë ejaetj.).</p> <p><i>Përgjigjuni në mënyrë përkatëse thirrjeve të fëmijës për lojë dhe aktivitete të përbashkëta. Mundësoni fëmijës vizita të shpeshta te familjarët (gjyshërit, hallat, dajallarët, etj.) në mënyrë që t'i njohë dhe të krijojnë lidhje të afërta me ta.</i></p>	<p>Fëmija fillon të kërkojë dhe ofrojë ndihmë personit të afërm gjatë lojës dhe aktiviteteve të tij/saj.</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën në veprimet e tij/saj të përditshme (të vishet, të hajë, të lajë duart, etj.). Kërkoni nga fëmija t'ju ofrojë gazetën, librin apo ndonjë mjet tjetër të lehtë. Mbështeteni sjelljen pozitive të fëmijës.</i></p> <p>Fëmija ka dëshirë të njohë personat që vijnë në familje.</p> <p><i>Përgjigjuni interesimit të fëmijës për të njohur personat që vijnë në rrethin e afërm. Ndihmoni fëmijën të kuptojë marrëdhëniet me personat që vijnë në familje.</i></p>	<p>Fëmija dallon dhe emërton personat e njohur në fotografi dhe incizime filmike (p.sh. festa e familjes, kopshtit, etj.).</p> <p><i>Ofroni fëmijës të shikojë fotografi apo incizime filmike të festave të ndryshme. Nxitni fëmijën t'i emërtojë personat të cilët i njeh dhe të veçojë afërsinë me ta.</i></p> <p>Fëmija bisedon për anëtarët e familjes dhe aktivitetet që kryen secili prej tyre.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që t'ju tregojë për anëtarët e familjes, aktivitetet e tyre dhe lidhjen e tij/saj me secilin anëtar të familjes. Stimuloni fëmijën (vajzë dhe djalë) të flasë pa u ndikuar nga stereotipet gjinore (p.sh. mami e babi vozisin automobilin, unë (djali dhe vajza) i ndihmoj mamit të pastrojë dhomën e ditës etj.</i></p>	<p>Fëmija flet lirshëm me persona të afërm për veten e tij/saj, shtëpinë dhe komunitetin.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të flasë dhe dëgjoni me kujdes kur ai/ajo tregon për veten e tij/saj, shtëpinë dhe komunitetin. Stimuloni fëmijën të flasë për anëtarët e shtëpisë dhe komunitetit dhe sfidoni atë të flasë pa u ndikuar nga stereotipet gjinore (detyrat e babait, aktivitetet e nënës, shoqes, shokut) p.sh. vajzat dhe djemtë luajnë së bashku me vetura, mami dhe babi përgatisin së bashku tavolinën etj.).</i></p> <p>Fëmija parashtron pyetje për ndonjë person të cilin e sheh për herë të parë në afërsinë e tij/saj dhe nuk e njeh.</p> <p><i>Prezantoni fëmijës personin për të cilin pyet dhe përgjigjuni pyetjes së fëmijës rreth personit.</i></p>



Nënfusha – Zhvillimi social

Standardi 2. Fëmija mund të ndërveprojë me personat përreth (të rritur dhe fëmijë të tjerë)

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija këmben shikimet me personat përreth, sidomos me nënën.</p> <p><i>Përgjigjuni shikimeve të fëmijës, me shikim, buzëqeshje dhe mimikë .</i></p> <p>Fëmija përpiqet të prekë flokët apo fytyrën e fëmijës që i afrohet.</p> <p><i>Lejoni prezencën e fëmijës tjetër afër fëmijës, por gjithnjë nën mbikëqyrjen tuaj.</i></p>	<p>Fëmija ofron lodrën e tij/saj për të luajtur më të rriturit.</p> <p><i>Përgjigjuni aktivisht ndërveprimit të nxitur nga fëmija. Gjatë ndërveprimit me fëmijë komunikoni në mënyra të ndryshme, bëjeni fëmijën të ndihet mirë.</i></p> <p>Fëmija, ndërvepron me fëmijë duke i ofruar lodrën e tij/saj, por reagon me të qarë nëse fëmija ia merr lodrën.</p> <p><i>Krijoni mundësinë që fëmija të qëndrojë me fëmijë të tjetër. Nxitni fëmijën që t'i ndajë lodrat me fëmijë të tjerë.</i></p>	<p>Fëmija tregon interesim që të marrë pjesë në veprimtari të përbashkëta me të rriturit.</p> <p><i>Lejoni fëmijën që më ndihmën tuaj të marrë pjesë në veprimtari të përbashkëta (gjatë mbathjes, veshjes, ushqyerit, pastrimit etj.).</i></p> <p>Fëmija preferon të qëndrojë me bashkëmoshatarë dhe të luajë me shokë për një kohë të caktuar.</p> <p><i>Krijoni kushte që fëmija të mund të luajë me shokë. Nxitni fëmijën të flasë për lojë me shokë.</i></p>	<p>Fëmija kërkon përfshirjen e të rriturve në lojën e tyre.</p> <p><i>Përgjigjuni iniciativës së fëmijës. Merrni pjesë aktivisht në lojë, provoni të ndërroni rolet gjatë lojës me fëmijë.</i></p> <p>Fëmija rri me fëmijë, por preferon të luajë vetëm.</p> <p><i>Organizoni aktivitete që nxisin fëmijën t'i bashkëngjitet grupit të fëmijëve.</i></p>	<p>Fëmija dëshiron të ndihmojë të rriturit.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës që nëpërmjet lojës të plotësojë dëshirën e tij/saj për të ndihmuar në aktivitete ditore (rregullimin e dhomës, pastrimin e lodrave, ujitjen e luleve etj.).</i></p> <p>Fëmija fillon të bashkëpunojë me të tjerët gjatë lojës – jep dhe merr sendet (mjetet e aktiviteteve për fëmijë) lodrat.</p> <p><i>Krijoni kënde të lojërave për fëmijë, ku ata mund të luajnë lojërat e tyre të pëlqyera dhe mund të ndërrojnë lodrat me njëri-tjetrin.</i></p>	<p>Fëmija bashkëpunon me të rriturit në zgjidhjen e problemeve të tij/saj.</p> <p><i>Flisni me fëmijën për problemin e tij/saj. Nxitni atë të tregojë në hollësi problemin që ka, kërkonte ide për zgjidhje të problemit, ofroni mbështetjen tuaj në këtë proces.</i></p> <p>Fëmija ndërvepron me fëmijë të tjerë përmes lojërave ekipore dhe veprimtarive në grupe.</p> <p><i>Mundësoni fëmijëve veprimtari në të cilat bashkëpunojnë ngushtë njëri me tjetrin.</i></p> <p><i>Bisedoni me fëmijën se sa është e rëndësishme të marrë pjesë në lojëra ekipore dhe veprimtari në grupe pa bërë dallime gjinore.</i></p>	<p>Fëmija përshëndetet me personat e njohur kur takohet në mjedise të ndryshme me zgjatje të dorës apo me shprehjet mirëmëngjesi, mirëdita, etj.</p> <p><i>Çdoherë që takoheni me fëmijën, përshëndeteni atë. Kërkonte nga fëmija që të njëjtën gjë ta bëjë edhe me persona të tjerë të njohur.</i></p> <p>Fëmija shoqërohet me bashkëmoshatarë -ka shokë në lagje, në kopsht - shkollë, etj.</p> <p><i>Krijoni mundësi që fëmija të shoqërohet me bashkëmoshatarë të rrethit të tij/saj. Nxitni aktivitete në të cilat fëmija (djalë dhe vajzë) do të marrë pjesë në veprimtari të përbashkëta.</i></p>



Nënfusha: Zhvillimi emocional
Standardi 1. Fëmija demonstroi se njih konceptin për veten³

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija luan me duart e veta.</p> <p><i>Vendoseni fëmijën në ambient të përshtatshëm ku mund ta eksplorojë veten e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija njihet (mund të tregojë) disa pjesë të trupit të tij/saj kur i kërkohet nga të tjerët (p.sh. koka, goja, hunda, dora, këmba, etj.).</p> <p><i>Gjatë lojës dhe aktivitetëve të tjera me fëmijën emërtoni pjesët e trupit të tij/saj dhe kërkoni që t'i prekë ato.</i></p> <p>Fëmija reagon ndaj imazhit të tij/saj në pasqyrë.</p> <p><i>Vendoseni fëmijën para pasqyrës.</i></p>	<p>Fëmija tregon emrin e vet dhe sa vjet i ka.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të prezantojë veten me emër dhe të tregojë moshën - vitet.</i></p> <p>Fëmija përgjigjet kur e thërrasin me emrin e tij/saj.</p> <p><i>Drejtohu fëmijës çdoherë me emrin e tij/saj. Lavdëroni fëmijën sa herë që përgjigjet kur e thërrasin me emrin e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija përdor më shpesh fjalët “është imja” për lodra, veshjet.</p> <p><i>Flisni me fëmijën për gjërat që u përkasin atyre dhe të tjerëve; p.sh., bluza e nënës, kukulla e motrës, telefoni i babait, etj. Nxitni fëmijën që të përdorë fjalinë “është imja” për gjërat e tij/saj.</i></p> <p>Fëmija imponon zgjedhjen e tij/saj duke përdorur “dua që”, “unë mund/duhet”, etj.</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën për gjërat që ata i pëlqejnë; tregoni për vlerat e tyre. Respektoni zgjedhjet e tyre për aq sa ato nuk janë të dëmshme për sigurinë e fëmijës.</i></p> <p>Fëmija njihet gjërat dhe lodrat personale.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës të tregojë, të emërtojë gjërat dhe lodrat personale, si p.sh. pjesë të veshjes, lodrat e preferuara, etj.</i></p>	<p>Fëmija njihet disa tipare fizike dhe gjëra personale (p.sh. ngjyrën e flokëve, syve, çantën, xhakëtën etj.).</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën për karakteristikat fizike dhe gjërat personale të tij/saj, organizoni lojëra dhe aktivitete të ndryshme ku fëmijës i jepet mundësia të tregojnë tiparet më të veçanta fizike dhe gjërat personale të tij/saj.</i></p> <p>Fëmija paraqet vetveten përmes lojës në role dhe situata të ndryshme (unë jam mësuesi, mjeku, prindi etj.).</p> <p><i>Organizoni lojëra dhe aktivitete të ndryshme ku fëmijës i jepet mundësia të tregojë veten (p.sh., loja e doktorit, kuzhinierit, shoferit)</i></p> <p>Fëmija shfaq interesim për të ruajtur gjërat (p.sh. veshjet, librat etj.) dhe lodrat personale.</p> <p><i>Krijoni një ambient personal ku fëmija mund t'i ruajë gjërat e tij/saj. Provoni që vetë të jeni shembull për këtë.</i></p>	<p>Fëmija iu tregon të tjerëve për veten dhe familjen.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që në aktivitete ndërvetë me të tjerët të shkëmbejë informata rreth vetes, familjes. Dëgjoni me kujdes dhe aktivisht kur fëmija shpreh mendimin e vet për veten e tij/saj. Stimuloni fëmijën të mendojë dhe të flasë pa u ndikuar nga stereotipet gjinore (p.sh. babi dhe mami bëjnë drekën së bashku).</i></p> <p>Fëmija e di kush është djalë e kush vajzë.</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën për gjininë e njerëzve të tjerë. Ndhmoni atë që të njohë karakteristikat kryesore që dallojnë gjininë e njerëzve. Inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) të bëjë dallimet fizike e shoqërore (p.sh. djemtë kanë mjekër, vajzat nuk kanë mjekër; babai dhe mami kujdesen për fëmijën, babai dhe mami shkojnë në punë etj.) dhe stimuloni të flasë pa u ndikuar nga stereotipet gjinore.</i></p> <p>Fëmija fillon të bëjë veprime në mënyrë të pavarur (për shembull: krijon këndin e lodrave të tij/saj dhe gjërave të tjera personale).</p> <p><i>Inkurajoni dhe lejoni pavarësinë e fëmijës në veprimtaritë e përditshme.</i></p>	<p>Fëmija tregon pozicionin e tij/saj në familje, në kopsht – shkollë, tregon për gjuhën që flet dhe vetveten.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të tregojë për pozitën e tij/saj në familje, kopsht etj. Dëgjoni me kujdes dhe aktivisht kur fëmija shpreh mendimin e vet dhe tregoni interesim kur ai/ajo bën këtë. Stimuloni fëmijën të flasë pa bërë dallime gjinore dhe pa u ndikuar nga stereotipet gjinore (p.sh. vajza/djalë ndihmon në punët e shtëpisë).</i></p> <p>Fëmija bëhet i vetëdijshëm për identitetin personal, bisedon rreth vetvetes dhe ideve të tij/saj.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës që nëpërmjet lojës dhe bisedës t'i shprehë vlerat personale, idetë, rolin, detyrat e tij/saj. Dëgjoni me kujdes dhe inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) kur shpreh mendimin e tij/saj pa u ndikuar nga stereotipet gjinore (p.sh. djali dhe vajza janë/është më i fortë, vajza është më e butë).</i></p>

³ Ky standard mund të realizohet duke i informuar fëmijët me njohuri bazë për dallime biologjike, por mund të stimulohet edhe diskutimi e sfidimi i pozitës, roleve, sjelljeve nga aspekti gjinor (shoqëror) përmes aktiviteteve të ndryshme (p.sh. rolet e anëtarëve të familjes, roli e pozicioni i fëmijës në familje etj.).

Nënfusha – Zhvillimi emocional
Standardi 2. Fëmija përjeton, njeh dhe shpreh emocionet

	0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
	Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija gëzohet kur sheh një fytyrë të njohur.</p> <p><i>Përcillni buzëqeshjet e fëmijës dhe reagoni me buzëqeshje.</i></p>	<p>Fëmija shpreh disa emocione përmes shprehjeve të fytyrës (gëzimin, gërdinë, inatin, zemërimin, etj.)</p> <p><i>Përgjigjuni në mënyrë adekuate emocioneve të fëmijës të shprehura përmes fytyrës së tij/saj.</i></p> <p>Fëmija kënaqet kur këndohet dhe luhet me të.</p> <p><i>Përsëritni aktivitete që sjellin lumturi për fëmijë (p.sh. luani dhe këndon).</i></p>	<p>Fëmija gëzohet kur vijnë në vizitë njerëz të afërm (gjyshja, axha etj.).</p> <p><i>Përpiquni që fëmijës t'i siguroni kontakte me të afërm që e bëjnë të ndihet i gëzuar.</i></p> <p>Fëmija e ndërpret lojën dhe aktivitetet e tjera, kur një fëmijë tjetër fillon të qajë.</p> <p><i>Përpiquni të qetësoni fëmijën që qan dhe nxitni fëmijën që përsëri të vazhdojë lojën e aktivitetet e tjera.</i></p>	<p>Fëmija përjeton emocione të tjera dhe di t'i shprehë ato me anë të lëvizjeve të fytyrës: buzëqesh kur është i/e lumtur, qan kur është i/e mërzitur ose zemëruar, etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të përdorë fjalët për të shprehur emocionet e veta.</i></p> <p>Fëmija nuk dëshiron të ndajë lojën dhe aktivitetet me bashkëmohatarë.</p> <p><i>Organizoni aktivitete që nxisin fëmijën t'i bashkëngjitet bashkëmohatarëve. Lavdëroni fëmijën sa herë që luan me bashkëmohatarë dhe nuk shfaq shenja të largimit nga moshatarët.</i></p> <p>Fëmija tregon ndjeshmëri ndaj moshatarëve të vet, p.sh., kur një fëmijë qan, mundohet të ndihmojë, ose ta bëjë të buzëqeshë)</p> <p><i>Inkurajoni simulimin e situatave/lojërave ku më të dobët (fëmijët, kafshët) gjithmonë ndihmohen dhe mbështeten nga të rriturit.</i></p>	<p>Fëmija përdor mimikën dhe gjestet për të shprehur emocione të ndryshme.</p> <p><i>Tregoni fëmijës fotot e personave me shprehje të ndryshme të fytyrave. Inkurajoni fëmijën t'i emërojë ata dhe po ashtu të veprojnë ndaj këtyre emocioneve.</i></p> <p>Fëmija shpreh kënaqësinë e tij/saj kur arrin të ngushëllojë fëmijën tjetër.</p> <p><i>Përkraheni fëmijën kur përpiqet të ngushëllojë fëmijën tjetër. Shprehni kënaqësinë tuaj për suksesin e tij/saj.</i></p> <p>Fëmija akoma nuk dallon realitetin nga imagjinata, mund të shprehë frikë nga e panjohura dhe fenomenet, terri, vetëtima etj.</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën t'i pranojë emocionet negative sikurse: frika ose ankthi, diskutoni dhe tregoni mënyrat e duhura për t'i shprehur ato dhe për t'i larguar.</i></p>	<p>Fëmija njeh dhe emëron disa emocione, duke dhënë arsye për ndjenja specifike: gëzohem sepse do të shkojmë të luajmë, jam i mërzitur sepse nuk më punon lodra, kam frikë sepse jam vetëm, etj.</p> <p><i>Bisedoni me fëmijë për emocionet, emëroni emocionet e fëmijës (djalë dhe vajzë) dhe të tjerëve, p.sh., Dukeni të lumtur, apo të mërzitur!</i></p> <p>Fëmija ndjen dhe shpreh dhembshuri ndaj të rriturve dhe moshatarëve (p.sh. kur dikush lëndohet).</p> <p><i>Lejoni fëmijën të ndjehet ashtu siç ndjehet. Kur vëreni se shfaq dhembshuri ndaj të tjerëve bisedoni me të dhe ndihmoni të tejkalojë situata të tilla.</i></p> <p>Fëmija njeh rezikun dhe frikësohet.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të flasë për frikën e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija i shpreh emocionet nëpërmjet lojës, përpiqet të ndihmojë shokun/shoqen (p.sh. në gjetjen e lodrës së humbur etj.).</p> <p><i>Mundësoni fëmijës që çdo ditë, nëpërmjet lojës t'i ndjejë dhe lirisht t'i shfaqë emocionet pa bërë dallime gjinore.</i></p> <p>Fëmija flet për ngjarjet e ditës duke i shoqëruar me emocione, p.sh. jam i/e gëzuar që do të shkoj mysafir, po qaj se e lëndova këmben, jam i/e frikësuar nga qeni, etj.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të tregojë përjetimet emocionale të shoqëruara me emocione.</i></p>	

Nënfusha – Zhvillimi emocional
Standardi 3. Fëmija mund të manifestojë aftësi të vetërregullimit të emocioneve

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija qetësohet kur sheh fytyra të të rriturve ose kur dëgjon zërat e tyre.</p> <p><i>Flisni me fëmijën duke e mbajtur afër.</i></p>	<p>Fëmija shpreh gëzimin për suksesin e tij/saj në ndonjë veprimtari duke qeshur, duke ngritur duart lart apo duke bërë turr nga kënaqësia.</p> <p><i>Shoqëroni gëzimin e fëmijës me veprime të njëjta.</i></p>	<p>Fëmija shpreh kënaqësinë e tij/saj haptazi kur tregohet dashuri dhe vëmendje ndaj tij/saj (buzëqesh, është aktiv dhe gazmor).</p> <p><i>Përfshini fëmijën në aktivitete ku nevojitet pjesëmarrje e tyre dhe vëmendje nga ju.</i></p> <p>Fëmija e ndal hidhërimin pasi që t'i kthehet lodra nga fëmija tjetër.</p> <p><i>Organizoni lojëra dhe aktivitete të ndryshme ku fëmijës i jepet mundësia t'ia japë lodrën e tij/saj fëmijës tjetër dhe ofroni zgjidhje alternative, p.sh. duke i preferuar fëmijës të luajë me një lodër tjetër - kubet, kukullat, etj.</i></p>	<p>Fëmija tregon dashuri për fëmijët të cilët janë më të vegjël, iu buzëqesh, i ledhaton etj.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të luajë me fëmijë më të vegjël nën përkujdesjen tuaj dhe inkurajoni ata që të shprehin dashurinë dhe përkujdesin ndaj tyre.</i></p> <p>Fëmija tejkalon zemërimet e çastit në situata të tërhiqet vëmendja.</p> <p><i>Bisedoni me fëmijën duke e pyetur për shkaqet e zemërimit. Inkurajoni fëmijën që ta përshkruajë zemërimin.</i></p>	<p>Fëmija e ndalon veprimin kur i thuhet "JO".</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të flasë për lidhjet e tij/saj me anëtarët e familjes, shokët, etj.</i></p> <p>Fëmija me vështirësi kontrollon të qarit dhe të bërëtiturit në vendet publike.</p> <p><i>Intervenoni me kujdes të veçantë atëherë kur fëmija ka problem rreth kontrollit të qarit të bërëtiturit. Tregoni fëmijës se ju e kuptoni porse kjo nuk është mënyra si duhet të veprojë.</i></p>	<p>Fëmija ndan emocionet me të tjerët (kur dikush lëndohet, kur dikush është i/e gëzuar etj.).</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përshkruajë emocionet e të tjerëve në situata të ndryshme.</i></p> <p>Fëmija pret në rend për kryerjen e ndonjë veprimtarie që i pëlqen (p.sh. të luhatet në luhatëse ose të marrë ushqimin, lëngun etj.)</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që me durim të presë kryerjen e ndonjë veprimtarie.</i></p>	<p>Fëmija shpreh vetëkontroll në masë të konsiderueshme ndaj emocioneve të tij/saj, si ndaj: gëzimit, dashurisë, zemërimit, pikëllimit, frikës, etj.</p> <p><i>Lejoni fëmijës të shprehë emocionet e tij/saj dhe e mbështetni fëmijën kur shpreh vetëkontroll, p.sh. lavdërojeni...</i></p> <p>Fëmija e kupton sjelljen e drejtë dhe të gabuar dhe varësisht nga sjellja reagon emocionalisht.</p> <p><i>Lavdëroni fëmijën dhe jepni kurajë kur me kohë kupton sjelljen e gabuar dhe kërkon falje në mënyrë të duhur. Bisedoni me fëmijën (djalë dhe vajzë) se si ndikon sjellja e tyre te të tjerët.</i></p>



ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURITË E PËRGJITHSHME

Të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, kulture, etniciteti, race, lindin për të mësuar dhe janë të gatshëm që në lindjen e tyre të përjetojnë botën përreth. Që nga fëmijëria e hershme fëmijët duhet stimuluar të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin e njohjes dhe njohurive të përgjithshme. Kur për ta ofrohet stimulim, ushqim dhe një ambient i sigurt, ata përdorin të gjitha shqisat e tyre për të eksploruar atë që i rrethon. Fëmijët që në vitin e parë të lindjes, prekin dhe shijojnë çdo gjë që ata mundin dhe në këtë mënyrë fillojnë të mësojnë rreth formave, madhësisë, përbërjes dhe funksionimit të objekteve. Ata shohin dhe dëgjojnë objektet përreth tyre dhe në mënyrë të veçantë janë të tërhequr nga fytyra dhe zërat. Zhvillimi njohës definohet si të menduarit, zgjidhja e problemeve, kuptimi i koncepteve, procesimi i informatës dhe inteligjenca e përgjithshme. Përmes lojës dhe eksplorimit të botës, fëmijët fillojnë procesin e zbulimit. Me çdo objekt me të cilin ballafaqohen ata marrin informata që duke u rritur mësojnë t'i lidhin këto informata me njëra-tjetrën. Më rritjen e aftësive njohëse, fëmijët fitojnë aftësinë e drejtimit të veprimeve të tyre.

Pikat kryesore të cilat priten nga fëmija 0-6 vjeç në aspektin e zhvillimit njohës janë: aftësia e fëmijës për të menduar, mbledhur dhe përdorur informacionin, aftësia për të zgjidhur probleme në raport me nivelin e zhvillimit të fëmijës, aftësia për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimi i kreativitetit dhe iniciativës.

Proceset njohëse të shtjelluara në këtë fushë zhvillimi janë si më poshtë:

Nënfusha: Të menduarit dhe logjika

Standardi 1: Fëmija demonstroi aftësinë për të hulumtuar dhe zbuluar ambientin përreth

Nënfusha: Shkenca (natyra dhe shoqëria)

Standardi 1: Fëmija mbledh informata rreth ambientit përmes observimit dhe manipulimit me të

Standardi 2: Fëmija observon dhe përshkruan botën e gjallë (bimët dhe kafshët)

Standardi 3: Fëmija observon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë

Standardi 4: Fëmija mëson për njeriun si një qenie sociale

Nënfusha: Shprehja e kreativitetit

Standardi 1: Fëmija demonstroi aftësi të dallojë tinguj të ndryshëm

Standardi 2: Fëmija tregon interes për pjesëmarrje aktive në aktivitete muzikore

Standardi 3: Fëmija tregon interes për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vizuale

Nënfusha: Zhvillimi matematikor

Standardi 1: Fëmijët zhvillojnë të kuptuarit e numrave dhe numërimit

Standardi 2: Fëmijët zhvillojnë të kuptuarit e hapësirës, figurave themelore gjeometrike dhe matjes së madhësive

Standardi 3: Fëmijët klasifikojnë, grupojnë dhe krahasojnë objekte

Nënfusha: Të menduarit dhe logjika

Standardi 1: Fëmija është i aftë të hulumtojë dhe të zbulojë gjëra të reja

0-6 muaj	0 - 2 vjeç		2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija i përgjigjet ngacmimit të fortë me shprehje të veçantë në fytyrë (p.sh. shije të këqija etj.).</p> <p>Fëmija shpesh e lëshon lodrën për të parë se çfarë do të ndodhë.</p> <p><i>Zgjatjani lodrën që e hedh dhe përsëriteni veprimin shpesh.</i></p>	<p>Fëmija përsërit veprimet shumë shpesh derisa të kuptojë se veprimi shkakton efekte. (Shtyp butonin e TV ose të radios)</p> <p><i>Lejojani fëmijës tuaj që të eksplorojë ambientin përreth. Lejoni fëmijën të përdorë mjetet shtëpiake si drejtuesin e TV, radios, nën mbikëqyrjen tuaj.</i></p> <p>Fëmija shikon brenda objekteve. Hap dhe mbyll sirtarin.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të hapë dhe mbyllë sirtarët dhe pyeteni arsyen pse po e bën një veprim të tillë.</i></p>	<p>Fëmija vendos dy objekte, lodra bashkë njëren me tjetrën.</p> <p><i>Mundësojani fëmijës të luajë me dy objekte që duhet të bashkohen dhe diskutoni me fëmijën arsyet pse duhen bashkuar.</i></p> <p>Fëmija imiton veprimet e të tjerëve, (p.sh. ushqen kukullën me lugë, i jep ujë me gotë, etj.).</p> <p><i>Ofroni fëmijës lodra të cilat mund t'i përdorë për t'u përkujdesur (p..sh. kukulla për vajza dhe djem).</i></p>	<p>Përdor lodrat sipas funksionit (p.sh. përdor kamionin si transportues të dheut etj.).</p> <p><i>Mundësoni fëmijës që të ketë qasje në objekte të cilat mund t'i përdorë në lojë.</i></p> <p>Fëmija tenton të hapë, mbyllë ose edhe t'i thyej lodrat me të vetmin qëllim që t'i njohë më mirë ato.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës të ketë qasje në objektet e sigurta që janë në shtëpi dhe nxitni fëmijën të zbulojë si dhe pse përdoren.</i></p>	<p>Fëmija përdor materiale të ndryshme kur luan (drurin, shkopin, gotën plastike, tenxheren, kapakët etj.) .</p> <p>Fëmija parashtron pyetje për atë që sheh dhe dëgjon.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të pyesë dhe përgjigjuni me aq informata sa keni.</i></p>	<p>Fëmija çmonton dhe përsëri monton lodrat e ndryshme.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën (vajzë dhe djalë) në aktivitete të tilla dhe ndihmoni në rast se ka vështirësi. Pyeteni fëmijën se çfarë ka dëshirë të bëjë kur është duke montuar objekte të ndryshme.</i></p> <p>Fëmija zëvendëson një objekt me një tjetër gjatë lojës p.sh. digitronin e përdorë si mikrofon).</p> <p><i>Merrni pjesë së bashku me fëmijën në pjesë të vogla loje ku edhe ju përdorni objekte të ndryshme për të zëvendësuar pushkën, mikrofonin, peshoren etj.</i></p>	<p>Fëmija vëzhgon dhe diskuton për ndryshimet të cilat i vëren (p. sh.: këtu ka ndërtesë të re, më parë nuk ka pasur).</p> <p><i>Dilni sa më shpesh në natyrë në mënyrë që fëmija të vëzhgojë dhe të diskutojë ndryshimet që ndodhin në ambientin përreth.</i></p>

Nënfusha: Shkenca (natyra dhe shkenca)

Standardi 1: Fëmija mbledh informata për ambientin nëpërmjet vëzhgimit dhe manipulon me këtë

0 – 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija vëren dhe shtrin duart në drejtim të objekteve.</p> <p><i>Gjithmonë lejoni fëmijën të prekë gjëra që të ketë mundësi të krijojë një ide për ato gjëra. Sigurohuni që gjësendet që i janë ofruar fëmijës nuk janë të dëmshme nëse ata i fusin ato në gojë.</i></p>	<p>Fëmija prek , nuhat, afron te veshi objekte të ndryshme.</p> <p><i>Ofroni fëmijës gjësende që ata mund t'i prekin, nuhasin, shijojnë, etj.</i></p> <p>Fëmija përfshin objekte dhe njerëz në lojërat e veta.</p> <p><i>Luani me fëmijën dhe përfshini sa më shumë objekte në lojë.</i></p>	<p>Fëmija vëzhgon dhe manipulon me objekte të ndryshme në përpjekje për të gjetur të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre.</p> <p><i>Gjatë aktiviteteve të përditshme inkurajoni fëmijën të emërtojë përbërjen e objekteve (gota e plastikës, gota e qelqit, lodra e drurit etj.).</i></p> <p>Fëmija përdor shqisat (të pamurit, të dëgjuarit, të prekurit etj.) për të hulumtuar botën përreth vetes.</p>	<p>Fëmija emërton vetitë e disa objekteve dhe disa fenomeneve (shtëpia e madhe, shtëpia prej druri, shiu, ftohtë, bora, etj.).</p> <p><i>Gjatë leximit apo tregimeve të ndryshme përforconi faktet si p.sh. kjo shtëpi është e madhe. Lejoni fëmijën të komentojë gjithashtu.</i></p> <p>Fëmija shpreh interesim për të hulumtuar dhe të marrë pjesë në veprime të ndryshme (kur nëna është duke larë enët, kur babai pastron tavolinën etj.).</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën (djalin dhe vajzën) kur dëshiron të marrë pjesë në aktivitete që janë nën mbikëqyrjen tuaj. Përshkruani çfarë jeni duke bërë, në mënyrë që fëmija të kuptojë veprimet tuaja. Stimuloni vajzën dhe djalin të marrin pjesë në aktivitete e njëjta dhe t'i ndërrojnë vendet.</i></p> <p>Fëmija observon se si disa objekte janë të lidhura me fenomene të natyrës.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të observojë dhe demonstrojë lidhjen e objekteve me fenomenet si p.sh. kur bie shi të përdoret çadra.</i></p>	<p>Fëmija fillon të japë sqarime për marrëdhënie në mes dy objekteve.</p> <p><i>Nxitni fëmijën (djalin dhe vajzën) t'i përdorë objektet të lidhura me njëra-tjetrën (p.sh. objektet e vogla mund të hyjnë në një më të madh, për ta lëvizur automobilin nevojiten rrotat etj.).</i></p> <p>Fëmija kupton se ekzistojnë objekte për të hulumtuar ambientin (p.sh. magneti, syzet etj.).</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën ta përshkruajë atë që vëzhgon dhe lejoni t'i përdorë mjetet jostandarde në eksperimentet (provat) që bën</i></p>	<p>Fëmija fillon të japë sqarime për gjërat dhe fenomenet që e rrethojnë.</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën përmes aktiviteteve të cilat përfshijnë përdorimin e shumë objekteve të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën.</i></p> <p>Fëmija përdor në mënyrë të duhur pajisjet standarde për të hulumtuar ambientin (magnetin, xhamin zmadhuesin etj.).</p> <p><i>Ofroni fëmijës që së bashku me ju të kryejë matje të ndryshme.</i></p>	<p>Fëmija identifikon dhe përshkruan gjëra, fenomene dhe domethëniet e tyre, posaçërisht kur ato vijnë nga përvoja personale.</p> <p><i>Filsi me fëmijën rreth përvojave të tyre personale.</i></p> <p>Fëmija mbledh informata nga ambienti duke përdorur shqisat e veta përmes vëzhgimit dhe bisedës.</p> <p><i>Inkurajoni dhe dëgjoni me vëmendje opinionet e fëmijës në raport me atë si i kuptojnë marrëdhëniet mes objekteve të ndryshme. Ndihmoni fëmijën që të përshkruajë gjetjet nga fenomene të ndryshme ose veprime në mënyra të ndryshme siç janë: vizatimet, planet etj.</i></p>



Nënfusha: Shkenca (natyra dhe shoqëria)

Standardi 2: Fëmija vëzhgon dhe përshkruan botën e gjallë (bimët dhe shtazët)

0 – 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija i vëzhgon objektet e gjalla dhe bimët për një kohë të shkurtër, nëse janë përpara pamjes së tyre.</p> <p><i>Lejoni dhe bëni të mundur që fëmija të observojë bimë, kafshë. (Kafshët dhe bimët mund të jenë në formë lodre në mungesë të atyre të gjalla).</i></p>	<p>Fëmija fillon të imitojë kafshët.</p> <p><i>Bëni të mundur që fëmija të prekë, ledhatojë, t'ju marrë erë bimëve dhe kafshëve.</i></p> <p><i>Asnjëherë mos lejoni që fëmija t'ju afrohet kafshëve apo bimëve të cilat nuk janë të sigurta</i></p>	<p>Nëse i kërkohet, fëmija mund të emërojë ndonjë kafshë apo bimë.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të emërtojë bimë dhe kafshë të ndryshme si dhe t'i imitojë ato.</i></p> <p><i>Lejoni fëmijën që t'i vëzhgojë bimët dhe kafshët në sezone të ndryshme dhe lejoni të kujdeset për lulet apo t'i ushqejë kafshët me ndihmën tuaj</i></p>	<p>Fëmija përshkruan karakteristikat e thjeshta të kafshëve dhe bimëve.</p> <p><i>Ofroni fëmijës libra dhe piktura rreth kafshëve dhe bimëve me përmbajtje se si duken kafshët, si veprojnë ato, etj.</i></p> <p>Fëmija mund të përshkruajë shkurt se si jetojnë dhe rritet bota e gjallë.</p> <p><i>Me fëmijën vizitoni vende ku mund të vëzhgoni si rriten bimët dhe si jetojnë kafshët e ndryshme.</i></p>	<p>Fëmija përshkruan vetitë e bimëve dhe kafshëve (druri rritet lart, kjo është lulja, kjo është pema, kjo është lopa, ky është kali etj.).</p> <p><i>Mbështeteni fëmijën në njohjen e botës së gjallë duke mos e penguar që të ketë përvoja të drejtpërdrejta me bimët dhe kafshët.</i></p> <p>Fëmija di që bimët dhe kafshët kanë nevojë për ujë dhe ushqim.</p> <p><i>Lejojani fëmijës që të kujdeset për kafshët dhe bimët nën mbikëqyrjen tuaj.</i></p>	<p>Fëmija mund të vërejë ndryshimet e rritjes dhe zhvillimit të bimëve dhe kafshëve.</p> <p><i>Lejoni fëmijën që të marrë pjesë në aktivitete me bimët dhe kafshët (vizitoni kopshtin zoologjik, fermat etj.).</i></p> <p>Fëmija emëron dhe arrin t'i njohë dobitë e disa kafshëve dhe bimëve.</p> <p><i>Bëjani të mundur fëmijës të njihet me drunjtë që japin fruta, me kafshët shtëpiake etj.</i></p> <p>Fëmija sqaron marrëdhënie të thjeshta që ekzistojnë në mes të bimëve, kafshëve dhe ambientit (p.sh. lopa duhet të hajë bar).</p>	<p>Fëmija interesohet se si lind fëmija, pse vdes njeriu etj.</p> <p><i>Stimuloni kuriozitetin e fëmijës (djalë dhe vajzë) duke ju përgjigjur pyetjeve të tyre. Përdorni libra apo materiale të tjera (figura) për t'i treguar fëmijës rreth jetës së njeriut. Stimuloni bisedën duke mos bërë dallime gjinore (p.sh. të dy prindërit duhet të kujdesen për foshnjën).</i></p> <p>Fëmija tregon interesim për përkujdesje për bimët dhe kafshët</p> <p><i>Përfshini fëmijën në përkujdesje ndaj bimëve dhe kafshëve (ushqejnë, ujin lulet etj.) në ambiente të ndryshme, shtëpi shkollë etj.</i></p>

Nënfusha: Shkenca (natyra dhe shoqëria)

Standardi 3: Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë përreth tyre

0 - 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija reagon ndaj rrezeve të diellit dhe në zhurmat që krijohen nga shiu, bubullima, era etj .</p> <p><i>Mundësojani fëmijës që të vëzhgojë diellin, hënën, shiun. Nxirrni fëmijën jashtë në ambiente të hapura.</i></p>	<p>Fëmija bashkëvepron me materialet e botës përreth, (ujin, dheun, baltën etj.).</p> <p><i>Lejoni fëmijën të prekë tokën, të luajë me baltë, observoje shiun etj.</i></p> <p>Fëmija imiton tinguj dhe zhurma që vijnë nga fenomene të ndryshme. (Zhurmen e ujit, të lumit apo burimit, shiut, erës etj.).</p> <p>Imitoni së bashku me fëmijën.</p>	<p>Fëmija befashohet kur vë re që disa materiale ndryshojnë gjatë përdorimit. (Uji përzihet me rërë, krijohet balta etj.).</p> <p><i>Nxitni fëmijën që gjatë lojërave të përdorë materialet të ndryshme nga natyra në mënyrë që të arrijë njohje mbi karakteristikat e tyre.</i></p> <p>Fëmija kënaqet duke luajtur me ujë, baltë etj.</p>	<p>Fëmija fillon të dallojë që materialet e ndryshme në natyrë përbehen prej drurit, gurit, rërës, ujit, etj.</p> <p><i>Nxitni fëmijën t'i emërtojë vetitë e materialeve të ndryshme (drurit, ujit, rërës, ajrit etj.).</i></p> <p>Fëmija mund të dallojë ditën nga nata.</p> <p><i>Kërkoni nga fëmija të emërtojë aktivitetet që kryhen natën dhe ato që zhvillohen ditën.</i></p>	<p>Fëmija mund të përshkruajë vetitë e materialeve të ndryshme, guri është i fortë, uji është i lagët etj.</p> <p><i>Bëni aktivitete së bashku me fëmijën (djalë dhe vajzë) në të cilat përdorni materialet të ndryshme. Mbështeteni fëmijën që të mësojë duke përdorur të gjitha shqisat (prekjen, dëgjimin, shijen, në varësi të aktivitetit).</i></p> <p>Fëmija mund të përshkruajë disa veti të stinëve duke i ndërlidhur me veshjen.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të përshkruajë ngjarje personale të lidhura me stinët dhe veshjen.</i></p>	<p>Fëmija mund të emërtojë dhe dallojë pjesët e natyrës. (Një mal, një fushë, një lumë etj.).</p> <p><i>Dilni sa më shpesh me fëmijën në natyrë, në mënyrë që ai/ ajo të ecën dhe ta vëzhgoj atë.</i></p> <p>Fëmija emërton dhe dallon pjesë të ndryshme të kohës (ditë, natë, mëngjes, darkë, pasdite etj.).</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të bëjë lidhjen e aktiviteteve me kohën (po hamë drekë dhe është mesi i ditës etj.).</i></p>	<p>Fëmija mund të dallojë burimet natyrore dhe artificiale të ngrohjes dhe njeh përfitimin e tyre.</p> <p><i>Gjatë dimrit kur është e ndezur stufa, (kaloriferi) lejoni fëmijën t'i afrohet dhe e pyetni atë se çfarë ndjen dhe pse duhet i nxehti.</i></p> <p><i>Vizitoni me fëmijën qendrën e zjarrfikësve dhe flisni rreth mjeteve që ata përdorin për t'u mbrojtur nga zjarri.</i></p> <p>Fëmija njeh karakteristikat themelore të stinëve.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën t'i vizatojë stinët.</i></p> <p>Fëmija ka njohuri themelore për të komentuar ndryshimet e motit (ka re, që do të thotë se mund të bjerë shi).</p> <p><i>Komentoni së bashku me fëmijën proceset që ndodhin në natyrë në lidhje me motin. Përgatitni së bashku me fëmijën një kalendar mbi motin.</i></p>

Nënfusha: Shkenca (natyra dhe shoqëria)
Standardi 4: Fëmija mëson për njerëzit si qenie shoqërore

0 – 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija dallon zërat e anëtarëve të familjes.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të krijojë lidhje me të gjithë anëtarët e familjes.</i></p>	<p>Fëmija bashkëvepron me personat e familjes.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të luajë me familjarët dhe nxitni fëmijën t'ju përgjigjet kërkesave të familjareve.</i></p>	<p>Fëmija njeh me emra disa anëtarë të familjes.</p> <p><i>Nxitni fëmijën t'ju tregojë personat e familjes dhe atyre që janë të lidhur me familjen. Ofroni fëmijës albume me fotografitë e familjes.</i></p> <p>Nëse i kërkohet fëmija është në gjendje të tregojë disa pjesë të trupit.</p> <p><i>Vizatoni dhe nxitni fëmijën që t'i emërtojë pjesët e trupit.</i></p> <p>Fëmija imiton sjelljen e personave familjarë.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të imitojë familjarët.</i></p>	<p>Fëmija fillon të përshkruajë ngjashmërinë mes të rriturve dhe fëmijëve.</p> <p><i>Flisni me fëmijën rreth ndryshimeve mes tyre dhe juve.</i></p> <p>Fëmija tregon pjesë të trupit të njeriut.</p> <p><i>Ofroni fëmijës materiale në të cilat tregohen pjesët e trupit. Mundësojani fëmijës që të mësojë se çfarë mund të bëjnë pjesët e ndryshme të trupit.</i></p> <p>Fëmija është në gjendje të dallojë rezikun dhe lëndimin.</p> <p><i>Bëni të mundur që fëmija të vëzhgojë në filma apo ndodhi të ndryshme rreziqet e mundshme dhe diskutoni me të rreth tyre.</i></p>	<p>Fëmija mund të emërtojë disa cilësi të njeriut (p.sh. ne jetojmë me prindër, etj.).</p> <p><i>Nxitni fëmijën të emërtojë cilësitë e njeriut. Ofroni fëmijës libra, piktura apo filma në lidhje me atë se çfarë mund të bëjnë njerëzit dhe stimuloni diskutimin edhe nga aspekti gjinor.</i></p> <p>Fëmija mund të emërtojë disa organe të njeriut.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përshkruajë organet e trupit si dhe organet e shqisave. Inkurajoni të bëjë dallimin në mes të meshkujve dhe femrave.</i></p> <p>Fëmija përshkruan anëtarët e tjerë të familjes dhe rrethin e tij/saj të afërt, (p.sh. Beni është vëllai im).</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të jetë pjesëtar aktiv i aktiviteteve të ndryshme tradicionale (dita e pranverës etj.).</i></p>	<p>Fëmija kupton marrëdhëniet e ndryshme në familje (motër, vëlla, nënë, babë, gjysh).</p> <p><i>Lexoni ose tregoni fëmijës histori që tregojnë se si anëtarët e familjes janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin.</i></p> <p>Fëmija realizon disa aktivitete të kujdesit vetjak në mënyrë të pavarur (tenton të pastrohet, të hajë me pirun dhe thikë etj.).</p> <p><i>Ofroni mundësi fëmijës që të realizojë vetë aktivitetet mbi vetëkujdesjen.</i></p> <p>Fëmija ndihmon në punët e shtëpisë.</p> <p><i>Përfshini fëmijën në aktivitetet e ndryshme shtëpiake, lejojani atij/asaj që të jetë i/e pavarur. Stimuloni fëmijën të zgjedhë aktivitetin shtëpiak dhe inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet pa bërë dallim gjinor. (P.sh vëllai dhe motra bëjnë ëmbëlsirë, djali dhe vajza ndihmojnë në regullimin e kopshtit etj.).</i></p>	<p>Fëmija tregon, emëron dhe respekton disa rregulla të mirësjelljes.</p> <p><i>Diskutoni me fëmijën për sjelljet e pahijshme dhe kërkoni prej tij se çfarë mendon.</i></p> <p>Fëmija krijon preferenca për ushqimet e shëndetshme dhe merr pjesë në aktivitete fizike.</p> <p><i>Flisni me fëmijën mbi rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm, ushtrimeve fizike dhe pushimit.</i></p> <p>Fëmija kujdeset për higjienën personale.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të krihet vetë, vishet vetë, përzgjedh veshjen etj.</i></p>

Nënfusha: Shprehja e kreativitetit

Standardi 1: Fëmija demonstroi aftësi të dallojë tinguj të ndryshëm.

0 – 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija lëviz drejt lodrave dhe tingujve. Fëmija kthen kokën kur dëgjon zërin e ndonjë anëtarit të familjes (nënës, dados etj.).</p> <p><i>Lejojani fëmijës që të prekë dhe të vëzhgojë lodra me zhurmë. Thirreni fëmijën tuaj dhe vëzhgojini reagimet.</i></p>	<p>Imiton tinguj të kafshëve ose gjërave që bëjnë zhurmë.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të luajë me gjësende të ndryshme që ai të mund të zbulojë tinguj të ndryshëm.</i></p>	<p>Fëmija reagon në muzikë duke bërë lëvizje të ndryshme.</p> <p><i>Organizoni aktivitete që përfshijnë muzikë me ritëm.</i></p>	<p>Fëmija dallon kur dikush tjetër është duke kënduar apo recituar.</p> <p><i>Lejojani fëmijës që ai/ajo t'i bashkohet të kënduarit me të rriturin, por sqarojani fëmijës që të fillojë të këndojë kur i rrituri të fillojë.</i></p>	<p>Fëmija njeh dhe imiton tingujt e macës dhe qenit.</p> <p><i>Lejojani fëmijës (djalë dhe vajzë) që të imitojë tinguj të ndryshëm.</i></p>	<p>Fëmija njeh llojin e muzikës sipas ritmit (të shpejtë, të ngadalshëm).</p> <p><i>Lejojani fëmijës që të dëgjojë muzikën që atij/asaj i pëlqen dhe nxitni atë që të operojë vetë me pajisjet muzikore (TV, radion, një instrument, kasetofoni). Lejojani fëmijës që të marrë pjesë në lojëra të ndryshme duke kënduar në ritme të ndryshme.</i></p>	<p>Mund t'i këndojë tekstet të cilat i ka mësuar përmendsh.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën (djalë dhe vajzë) që të këndojë.</i></p>



Nënfusha: Shprehja e kreativitetit

Standardi 2: Fëmija shfaq interesim për muzikën dhe prirje individuale për aktivitete/veprimtari të ndryshme muzikore

0 – 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fëmija reagon me lëvizje dhe shprehje të fytyrës ndaj tingujve të këndshëm muzikorë.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të prekë dhe të vëzhgojë lodrat e zhurmshme, të mbajë në duar lodra apo vegla muzikore dhe me dorën tuaj ndihmoni të prodhojë tinguj.</i></p>	<p>Fëmija bën “muzikë” me lodra të ndryshme.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të luajë me objekte të ndryshme në mënyrë që të zbulojë tinguj të ndryshëm.</i></p>	<p>Fëmija përdor objekte për të krijuar tinguj të ndryshëm.</p> <p><i>Organizoni aktivitete ku fëmija dëgjon muzikë dhe nxitni që të lëvizë sipas ritmit ose karakterit të muzikës (shpejt, ngadalë, etj.). Inkurajoni fëmijën që t’i ketë lëvizjet sa më të lira.</i></p>	<p>Fëmija këndon në mënyrën e vet.</p> <p><i>Krijoni mundësi që fëmija të dëgjojë muzikë kryesisht këngë për fëmijë, por edhe këngë popullore me vlerë dhe të përshtatshme për moshën e tij.</i></p>	<p>Fëmija zgjedh muzikën që i pëlqen dhe shquan disa këngë të cilat i ka më për zemër.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të përdorë burime të ndryshme të muzikës si p.sh. TV, radio, CD etj.</i></p>	<p>Fëmija krijon lëvizje që marrin formë më përmbajtësore (një lloj vallëzimi sipas ritmit të muzikës).</p> <p><i>Lejoni fëmijën të dëgjojë muzikën e preferuar dhe të përcaktohet vetë për mënyrën se si do të shprehet kur dëgjon muzikë (mund të lëvizë, të vizatojë, të shoqërojë ritmin etj.).</i></p> <p><i>Nxitni fëmijën ta këndojë këngën duke e shoqëruar me lëvizje trupore pa dallim gjinie.</i></p>	<p>Fëmija shpreh interesim për muzikën të përbashkët (ansamble, grupe të vogla) dhe me përgjegjësi e interpreton pjesën e tij/saj duke u përpjekur që të koordinohet me melodinë.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të këndojë dhe të marrë pjesë në aktivitete ku këndohet. Duhet lënë të lirë mënyrën e inkudrimit të tij/saj.</i></p> <p><i>Organizoni aktivitete ku fëmijët muzikojnë në mënyrë të përbashkët, ndihmoni ata që të koordinojnë fillimin dhe mbarimin, por leni të lirë gjatë interpretimit të tyre... (kjo ju jep vetëbesim dhe guxim për të provuar prirjet e tyre krijuese dhe interpretuese).</i></p>

Standardi 3: Fëmija tregon interes për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme vizuale

0 - 2 vjeç			2-3 vjeç	3-4 vjeç	4-5 vjeç	5-6 vjeç
0-6 muaj	6-18 muaj	18-24 muaj				
<p>Fokuson shikimin në një foto, vizatim ose pasqyrë.</p> <p><i>Lejojani fëmijës që të shohë veten në pasqyrë. Tregoni fëmijës fotografi të ndryshme me ngjyra.</i></p>	<p>Fëmija eksperimenton me materiale të ndryshme për vizatim.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës të ketë qasje në materiale të ndryshme për vizatim (lapsa, shkumësa etj.).</i></p>	<p>Fëmija vizaton vija të ndryshme me lehtësi.</p> <p><i>Ofroni fëmijës lapsa dhe letër për vizatim etj.</i></p>	<p>Fëmija vizaton vijat ndërlidhëse, p.sh. një rrethojë etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të vizatojë në rërë, tokë etj.</i></p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që të vizatojë diçka specifike që ju ia kërkon.</i></p>	<p>Fëmija përdor ngjyrat e ujit dhe i përzien ato.</p> <p><i>Ofroni fëmijës ngjyra të ndryshme dhe lejoni që t'i përziej ato ngjyra.</i></p>	<p>Fëmija vizaton gjësende të njohura pa ndihmën e askujt</p> <p><i>Ofroni fëmijës materiale të ndryshme për të vizatur dhe lëreni atë të zgjedhë vetë.</i></p>	<p>Fëmija është në gjendje të përgatisë punime të ndryshme në materiale të ndryshme.</p> <p><i>Fëmija dekoron gjësende të ndryshme në vizatime. Fëmija është në gjendje të përgatisë punime të ndryshme në materiale të ndryshme.</i></p>



NËNFUSHA: ZHVILLIMI MATEMATIKOR

Që në fëmijërinë e hershme, fëmijët fillojnë të shqyrtojnë botën përreth tyre, botën që është e lidhur me konceptet matematikore. Zhvillimi i fëmijëve është i lidhur ngushtë me aktivitetet e përditshme dhe lojërat që mundësojnë të kuptuarit për hapësirën dhe orientimin në hapësirë. Ata fillojnë të krahasojnë madhësitë, të gjejnë modele në objekte të ndryshme, të lëvizin nëpër mjedisin ku jetojnë dhe fillojnë të mendojnë për zgjidhjen e problemeve. Në fëmijërinë e hershme, bazë e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me numra, është numërimi. Fëmijët, pavarësisht gjinisë (mashkull a femër) pëlqejnë të praktikojnë lojëra me numra dhe numërimet që nga koha kur ata fillojnë të flasin. Ata mësojnë për kuptimin e numrave gjatë përvojave të përditshme dhe kujdesi i të rriturve. Konceptet e hershme gjeometrike përfshijnë figurat, madhësitë, pozitën, hapësirën, lëvizjen dhe orientimin. Ndërkohë, gjeometria u ndihmon fëmijëve të përshkruajnë dhe të klasifikojnë botën fizike në të cilën ata jetojnë. Duke ndërtuar bazën për njohjen e figurave dhe shfrytëzimin e drejtë të emërtimeve të tyre, fëmijët zbulojnë madhësitë, format, pozitën dhe zhvendosjen e objekteve në mjedisin e tyre fizik.

Shkathtësitë matematikore fillojnë atëherë kur foshnja fillon të vërejë çfarë ka përreth. Të menduarit matematikor ndodh kur fëmija kërkon “një më shumë”, ose kur krijon modele sipas rregullave që i zbulon vetë. Krahasimi i

madhësive dhe inkurajimi nga të rriturit për përdorimin e fjalëve matematikore si më shumë, më pak, më i vogël se, i ndryshëm nga, u ndihmon fëmijëve të përshkruajnë madhësitë, format e objekteve dhe marrëdhëniet e objekteve ndërmjet vete. Zgjidhja e problemeve fokusohet në kuriozitetin e fëmijëve dhe aftësinë e tyre për të fituar, organizuar dhe për të shfrytëzuar informacionin. Të mësuarit për të modeluar, shqyrtuar, dhe shfrytëzuar konceptet e mbledhjes dhe zbritjes në situatat problemore, fillon me mundësinë e fëmijëve për të numëruar, grupuar, krahasuar objektet, dhe përshkruar të menduarit e tyre në situatat e përditshme. Për ndërtimin e bazës për njehësime, fëmijëve u nevojitet të vëzhgojnë të rriturit dhe të zbatojnë drejtpërdrejt konceptet matematikore gjatë lojërave dhe në aktivitetet e mbështetura nga të rriturit.

Nënfusha e matematikës është prezantuar përmes këtyre standardeve:

Standardi 1 : Fëmija zhvillon të kuptuarit e numrave dhe numërimit

Standardi 2 : Fëmija zhvillon të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësive

Standardi 3 : Fëmija klasifikon, grupon dhe krahason sende dhe objekte

Nënfusha : Zhvillimi matematikor

Standardi 1: Fëmija zhvillon të kuptuarit e numrave dhe numërimit

0 – 2 vjeç			24 deri në 36 muaj	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
	<p>Fëmija mund të tregojë me gishtërinj sa vjeç është.</p> <p><i>Pyetni fëmijën t'ju tregojë me gishtërinj sa vjeç është.</i></p>	<p>Fëmija përmend numra gjatë lojës.</p> <p><i>Ofroni fëmijës objekte "tërheqëse" për t'i numëruar. (Topa të butë, makina, kube etj.).</i></p>	<p>Fëmija numëron përmendsh deri në 5.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përdorë numrat dhe të numërojë gjatë aktiviteteve ditore, (p.sh. fëmija kërkon një ose "një më shumë" bonbone, pjesë të ëmbëlsirës, etj; numëron gjësende duke shtuar një më shumë.</i></p>	<p>Fëmija fillon të lidhë numrin me sendet e ndryshme.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të shoqërojë një për një objektet me numra përkatës (numrat-gishtërinjtë; numrat-dritaret; numrat- lulet, lapsat me ngjyra – me kapakët, etj.).</i></p>	<p>Fëmija lidh numrin me simbolin e numrit përkatës.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të emërtojë numrat që sheh në libra, gazeta, etj.</i></p> <p>Fëmija kërkon të jetë i pari (e para), i dyti (e dyta), i treti (e treta) etj. në lojë gjatë aktiviteteve ditore.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të rendit gjësendet sipas renditjes apo vetive të caktuara. Kujdesuni që fëmijët të lidhin radhitjen e numrave prej më të voglët te ai më i madhi dhe anasjelltas, gjatë aktiviteteve dhe lojërave.</i></p>	<p>Fëmija tregon se cili numër është pas ose para numrit 6</p> <p><i>Nxitni fëmijën që gjatë lojës apo numërimit të tregojë se cili numër është para , pas numrit përkatës</i></p> <p>Fëmija numëron me kuptim deri në 10.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përdorë numrat 0-10 në aktiviteteve e përditshme p.sh. sa libra janë në dollap, sa gota nevojiten për secilin anëtar të familjes etj.</i></p> <p>Fëmija fillon të zhvillojë mënyra të ndryshme për llogaritje të thjeshta matematikore.</p> <p><i>Ofroni fëmijës (djalë dhe vajzë) mundësinë të gjejë përgjigjen e pyetjeve (p.sh. në problemet me mbledhje apo zbritje pyetni atë: Sa mendon se duhet të shtojmë... Për të fituar ...?).</i></p>

Nënfusha: Zhvillimi matematikor

Standardi 2 : Fëmija zhvillon të kuptuarit e figurave themelore gjeometrike, hapësirës dhe matjes së madhësisë

0 deri në 2 vjeç			24 deri në 36 muaj	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija vëzhgon objekte të formave të ndryshme.</p> <p><i>Ofroni fëmijës të mbajë gjësende të buta, të parrezikshme të cilat i vëzhgon, mund t'i prekë dhe me të cilat mund të luajë.</i></p>	<p>Fëmija vëzhgon figurat themelore (trekëndëshin, katrorin, rrethin).</p> <p><i>Ofroni fëmijës lodra me forma trekëndëshi, katrori apo rrethi që ai/ ajo t'i vëzhgojë dhe të luajë me to.</i></p> <p>Fëmija tenton të futet në një kuti apo "tunnel", të bëjë vrima me gishtërinj në rërë, të mbushë dhe të zbrazë "kovën" me lodra etj.).</p> <p><i>Lejoni fëmijën të zbulojë vetë marrëdhëniet hapësinore gjatë lojërave.</i></p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të lëvizë në hapësirë, brenda dhe jashtë (ecën, zvarritet, kërcen, hidhet.</i></p> <p>Fëmija përdor fjalët "e madhe" dhe "e vogël".</p> <p><i>Ofroni fëmijës topa, lodra të madhësive të ndryshme dhe inkurajoni atë të marrë më të voglin ose më të madhin.</i></p>	<p>Fëmija me ndihmën e të rriturit vendos figurat e thjeshta në vendin përkatës (puzel apo lodra me forma).</p> <p><i>Ofroni fëmijës lodra me forma të thjeshta dhe nxitni atë t'i vendosë format në vendet përkatëse trekëndëshin, rrethin dhe katrorin.</i></p> <p>Fëmija përdor në mënyrë spontane fjalët përpara, prapa, mbi, nën, afër, etj.</p> <p><i>Nxitni fëmijën t'i vendosë lodrat mbi apo nën tavolinë, veturën ta vërë në garazh etj.</i></p> <p>Fëmija me ndihmën e të rriturit grupon objekte sipas madhësisë.</p> <p><i>Ofroni lodra me madhësi të ndryshme dhe ndihmoni fëmijën t'i ndajë të voglat nga të mëdhatë.</i></p>	<p>Fëmija fillon t'i identifikojë objektet sipas formës.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të luajë me lodra të formave të ndryshme (materiale të llojllojshme gjeometrike si, blloqe plastike, druri, shabllone) dhe kërkoni nga ai të emërtojë dhe t'i grupojë sipas formave (rrethore apo me kënde).</i></p> <p>Fëmija fillon t'i kuptojë fjalët si mbi, nën, afër, pas etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që ta fshehë lodrën pas vetes, të tregojë ku është topi (nën tavolinë, mbi tavolinë apo në shportë).</i></p> <p>Fëmija fillon t'i identifikojë objektet sipas madhësisë.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të luajë me lodra të madhësive të ndryshme dhe t'i grupojë ato sipas madhësisë (i madh, e vogël).</i></p>	<p>Fëmija klasifikon gjësende sipas një forme të caktuar.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës të klasifikojë dhe të emërtojë gjësendet në mjedisin e tyre sipas formave të ndryshme dhe të emërtojë ato (rrethore apo me kënde).</i></p> <p>Fëmija tregon për objektet që janë: para tij/ saj, pas tij/saj, afër tij/saj dhe larg nga ai/ajo.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën që t'i vështrojë objektet lart, poshtë dhe përreth tij, (lodra, orendi, shtëpi, pemë etj.) dhe nxitni të tregojë cilat objekte gjenden para tij/saj, pas, afër dhe larg tij/saj.</i></p> <p>Fëmija tregon interes për të bërë matjen e madhësive.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të luajë me peshore, (enë të plastikës të tejdukshme), metër, etj.</i></p> <p><i>Bisedoni me fëmijën gjatë aktiviteteve ditore për tema si (sot është më nxehtë se dje, a është mjaft e madhe kutia për t'i futur të gjitha lodrat?).</i></p>	<p>Fëmija i përdor figurat si rrethi, katrori, trekëndëshi dhe vetitë e tyre.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të krijojë përfaqësimin e figurave duke ndërtuar modele me vizatime, blloqe ndërtimi, plastelina dhe mjete të tjera. Kërkoni nga ai/ajo të grupojë figurat sipas vetive të tyre.</i></p> <p>Fëmija tregon objektet e zhvendosura në dhomë (p.sh. dollapit, orës, karriges etj. i ndërrohet vendi).</p> <p><i>Nxitni fëmijën të tregojë se ku ka qenë më parë vazoja, ora, karrigia etj.</i></p> <p>Fëmija bën matje jo të sakta me mjete jostandarde pëllëmbë, hapa, blloqe etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të bëjë matje dhe të krahasojë rezultatet p.sh. sa hapa është korridori, sa pëllëmbë është libri i tij/saj, topi i saj/tij etj.</i></p>	<p>Fëmija përshkruan figurat themelore gjeometrike.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të vizatojë figura të ndryshme, si shtëpi, kopshte, shkolla duke shfrytëzuar figurat bazë gjeometrike.</i></p> <p>Fëmija njih pozicionet para, pas, majtas, djathtas etj.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të luajë sipas rregullave të (para, pas, majtas, djathtas etj.).</i></p> <p>Fëmija kryen matjet me mjete jostandarde ose mjetet standarde.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të bëjë matje përmes përdorimit të pëllëmbës, litarit, hapit; ose shfrytëzimi i vizores, metrit, peshores për matje të ndryshme.</i></p>

Nënfusha: Zhvillimi matematikor

Standardi 3: Fëmija klasifikon, grupon dhe krahason sende dhe objekte

0 – 2 vjeç			24 deri në 36 muaj	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
0 deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija shikon objektet në mjedisin përreth tij/saj/saj.</p> <p><i>Vendosni fëmijën në mjedis tërheqës ku mund të shikojë sendet me ngjyra dhe madhësi të ndryshme.</i></p>	<p>Fëmija me ndihmë radhit gjësendet duke filluar nga e madhja.</p> <p><i>Ofroni fëmijës gjësende të madhësive të ndryshme (p.sh. balona, topa etj.) dhe nxitni t'i radhisë sipas madhësive.</i></p> <p>Fëmija me ndihmë grupon sendet sipas madhësisë.</p> <p><i>Ndihmoni fëmijën t'i vërë kubet e mëdha në një rreth anë, ndërsa kubet e vogla në anën tjetër.</i></p>	<p>Fëmija e mbulon objektin e vogël me objektin më të madh.</p> <p><i>Jepni fëmijës kube me madhësi të ndryshme, nxitni fëmijën që ta mbulojë kubin e vogël me kubin më të madh.</i></p> <p>Fëmija në mënyrë të pavarur grupon sendet sipas madhësisë.</p> <p><i>Jepni fëmijës objekte të madhësive të ndryshme (topa, kube, kukulla etj.) dhe nxitni që t'i veçojë sipas madhësisë.</i></p>	<p>Fëmija klasifikon gjësende dhe objekte sipas ngjyrës.</p> <p><i>Ofroni fëmijës sende dhe objekte të ndryshme që dallojnë sipas ngjyrës (p.sh. kuti dhe topa të kuq, të verdhë dhe të gjelbër). Nxitni fëmijën që t'i vendosë topat e kuq në kutinë me ngjyrë të kuqe, topat e verdhë në kutinë me ngjyrë të gjelbër etj.</i></p> <p>Fëmija i grupon objektet sipas ngjyrës (i kuq, e verdhë, i kaltër, e gjelbër) dhe i vendos në kutinë e ngjyrosur në mënyrë përkatese.</p> <p><i>Vendosni në mjedisin ku luan fëmija topa, kube, kukulla, balona etj. të ngjyrave të ndryshme dhe nxitni fëmijën t'i klasifikojë sipas ngjyrave.</i></p>	<p>Fëmija klasifikon gjësende sipas gjatësisë - prej më të shkurtës deri te më e gjata ose anasjelltas.</p> <p><i>Jepni fëmijës shkopinj apo lapsa me gjatësi të ndryshme dhe kërkoni të klasifikojë të gjatët në një anë dhe të shkurtrët në anën tjetër.</i></p> <p>Fëmija grupon sende dhe objekte në çifte - sipas karakteristikave dhe rregullave.</p> <p><i>Ofroni fëmijës mundësi që t'i grupojë sendet dhe objektet që u përgjigjen karakteristikave dhe rregullave të caktuara (p.sh. pjatën dhe lugën, enën dhe kapakun, këpucët dhe lidhëset, lulen dhe vazon).</i></p> <p>Fëmija krahason objekte sipas një forme të caktuar.</p> <p><i>Mundësoni fëmijës të krahasojë dhe të emërtojë objektet në mjedisin e tyre sipas formave të ndryshme dhe t'i emërtojë ato (p.sh. tavolina me kënde, letrat katrore etj.).</i></p>	<p>Fëmija klasifikon gjësende sipas numrit të shenjave apo vrimave.</p> <p><i>Ofroni fëmijës pulla me vrima të ndryshme dhe nxitni atë që pullat t'i ndajë sipas vrimave. Përsëriteni këtë aktivitet fillimisht për ndarjen e pullave me dy vrima, pastaj për pullat me katër vrima.</i></p> <p>Fëmija përshkruan dallimet dhe veçoritë e përbashkëta të sendeve dhe objekteve të grupuara.</p> <p><i>Ofroni fëmijës sende dhe objekte që kanë veçori të përbashkëta dhe dallime (p.sh. shkopinj, fije shkrepe, kube, blloqe etj.). Nxitni fëmijën që t'i përshkruajë veçoritë dalluese dhe të përbashkëta.</i></p> <p>Fëmija krahason madhësitë.</p> <p><i>Nxitni fëmijën t'i krahasojë rezultatet e paraqitura në tabelë (unë kam 4 kube, kurse ti një më shumë...) p.sh. unë jam më i/e gjatë se ti, etj.).</i></p>	<p>Fëmija klasifikon sende dhe objekte sipas disa veçorive (ngjyrës, madhësisë, formës etj.).</p> <p><i>Ofroni fëmijës sende dhe objekte të ndryshme që dallojnë sipas ngjyrës, madhësisë, formës etj. Nxitni fëmijën që t'i klasifikojë ato dhe të emërtojë klasifikimin e bërë (p.sh. lapsat me ngjyrë, lapsat pa ngjyrë, komat katrore, topat e mëdhenj, topat e vegjël etj.).</i></p> <p>Fëmija grupon sendet dhe objektet sipas cilësive të përbashkëta (p.sh. grupi i buqetave me lule, grupi i gjetheve, grupi i fëmijëve etj.).</p> <p><i>Nxitni fëmijën që në mënyrë të pavarur të formojë bashkësi me sende sipas cilësive të përbashkëta.</i></p> <p>Fëmija përdor rregulla kreative për krahasimin dhe paraqitjen e objekteve.</p> <p><i>Nxitni fëmijën që të krahasojë dhe përshkruajë veçoritë në mes të dy e më shumë objekteve (p.sh. veçoritë e dy automobilave, dy kukullave etj.). Pyetni fëmijën si e ka bërë krahasimin? Cilat janë dallimet e evidentuara? Cilat janë të përbashkëta? etj.</i></p>

QASJA NDAJ TË MËSUARIT

Periudha e fëmijërisë së hershme është koha kur të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, përkatësie etnike, kulture, race, mësojnë se si të mësojnë. Qasja ndaj të mësuarit është një fushë e veçantë e zhvillimit të fëmijës sepse përfshin në vetvete aftësitë specifike që tashmë janë mësuar në fushat e tjera të zhvillimit. Secila fushë tjetër e zhvillimit reflekton përmbajtjen e njohurive apo aftësive specifike, dhe ka të bëjë me mënyrën se si këto njohuri apo aftësi janë fituar në këto fusha. Qasja e fëmijëve ndaj të mësuarit i referohet natyrës së fëmijëve, gatishmërisë dhe stileve /tipave të të mësuarit, i referohet asaj se si fëmijët janë të orientuar dhe si e drejtojnë ata veten në procesin e të mësuarit, por gjithashtu i referohet edhe motivimit, sjelljeve dhe modeleve njohëse që shprehin fëmijët kur mësojnë diçka të re dhe çdoherë në një situatë të re apo të ndryshme.

Pavarësisht asaj se çfarë mësojnë, fëmijët duhet të përdorin aftësitë/shkathtësitë e qasjes ndaj të mësuarit si strategji pozitive për të drejtuar të mësuarit e tyre. Kurioziteti dhe interesi për ambientin që i rrethon dhe për çdo gjë të re që ndodh në të, janë komponentët e parë të qasjes ndaj të mësuarit. Marrja e iniciativës nga fëmijët dhe stimulimi nga të rriturit për ta zhvilluar atë përbëjnë komponentin tjetër të qasjes ndaj të mësuarit në të cilën fëmijët zhvillojnë gatishmërinë e tyre për të mësuar, por edhe mënyrën se si ata e drejtojnë veten në këtë të mësuar. Këmbëngulja, një tjetër komponent, tregon se si fëmijët në vazhdimësi merren me të njëjtën veprimtari apo aktivitet, madje edhe pas përballjes me pengesa apo vështirësi të ndryshme. Kreativiteti dhe imagjinata, si kompetent për të përshtatur, adaptuar materiale, veprimtari apo aktivitete në situata të reja apo me të tjera qëllime, shihet si komponenti i fundit i qasjes ndaj të mësuarit.

Gjatë viteve të para të jetës, këto aftësi të fëmijëve janë kryesisht të ndërlidhura me kohën e kaluar me fëmijët dhe me cilësinë e bashkëveprimit të prindërve, kujdestarëve, edukatoreve, rrethit të tyre dhe moshatarëve me ta. Fusha e qasjes ndaj të mësuarit përfshin të gjitha modelet e sjelljeve që fëmijët shfaqin kur përfshihen në detyra, punë, aktivitete të të mësuarit në të gjitha fushat e zhvillimit dhe reflektojnë se si fëmijët mësojnë. Dhe fëmijët mësojnë më mirë kur kurioziteti dhe interesi, iniciativa dhe këmbëngulja, kreativiteti dhe imagjinata janë të inkurajuara, të mbështetura dhe të ndërlidhura me të gjitha fushat e zhvillimit.

Kjo fushë prezantohet sipas këtyre standardeve:

Standardi 1 : Fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar për gjërat e reja

Standardi 2 : Fëmija është i/e aftë të marrë iniciativë në veprimtarinë e tij/saj

Standardi 3 : Fëmija tregon aftësi të marrë pjesë në disa aktivitete, veprimtari dhe të këmbëngulë në realizimin e tyre edhe kur përballet me pengesa apo vështirësi

Standardi 4: Në aktivitetet e përditshme fëmija përdor imagjinatën dhe kreativitetin

Standardi 5: Fëmija demonstroi aftësinë për të mësuar në mënyra të ndryshme përmes eksperiencave të tij/saj



Standardi 1 : Fëmija shpreh interes dhe kuriozitet për të mësuar për gjërat e reja

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija lëshon tinguj të ndryshëm dhe përgjigjet (gugat) kur dikush flet me të.</p> <p><i>Flitini fëmijës apo tundni një lodër me zhurmë në vende të ndryshme të dhomës.</i></p>	<p>Fëmija tregon interes për objektet e reja që janë afër tij/saj, por edhe në ambientin e tij/saj.</p> <p><i>Shtoni në ambientin ku luan fëmija lodra të ndryshme të reja në ngjyrë, formë, apo në tingujt që lëshojnë zë kur preken.</i></p>	<p>Fëmija fillon të pyesë rreth personave të tjerë që e rrethojnë.</p> <p><i>Njoftoni fëmijën me persona të tjerë, stimuloni kuriozitetin e tyre; sqaroni cilët janë personat, çfarë bëjnë etj.</i></p> <p>Fëmija tregon interes për aktivitete të reja dhe të ndryshme.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të angazhohet në aktivitetet që ai/ajo pëlqen apo që kërkon.</i></p>	<p>Fëmija tregon kuriozitet për të mësuar gjërat e reja përmes pyetjeve pse? kush? si? kur? nga? Etj.</p> <p><i>Stimuloni pyetjet e fëmijëve dhe jepni përgjigje të kuptueshme për moshën e tyre.</i></p>	<p>Fëmija kërkon informacion më të qartë, duke paraqitur aktivitete konkrete, veprime konkrete etj.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të pyesë rreth paqartësive që ka dhe gjithmonë, përgjigjuni në pyetjet e tyre (qoftë edhe me “nuk e di këtë”).</i></p>	<p>Fëmija pyet rreth ngjarjeve dhe ndodhive që janë të reja për të.</p> <p><i>Dëgjoni fëmijën dhe nxitni interesin e tij/saj për ngjarjet që janë të reja për të.</i></p>	<p>Fëmija me dëshirë angazhohet në diskutime rreth ngjarjeve dhe eksperiencave dhe kërkon më tepër informacion për to.</p> <p><i>Krijoni mundësi që fëmija të marrë përgjigje për informacionin e tij/saj nga burime të ndryshme (libri, lodrat plastike, hartat, muzetë, etj.). Inkurajoni dhe përfshini fëmijën në diskutimet që zhvillon rreth ngjarjeve apo eksperiencave, të jetë fëmija (djali dhe vajza) aktor kryesor në biseda, diskutime.</i></p>

Standardi 2 : Fëmijët janë të aftë të marrin iniciativë në veprimtarinë e tyre

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija buzëqesh apo lëviz kur i afrohet një person i afërt.</p> <p><i>Luaj bashkë me fëmijën, buzëqeshi dhe ndiq aktivitetin e tij/saj, inkurajo dhe stimulo iniciativën e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija e zgjedh vetë lodrën që do ndërmjet lodrave të ofruara, materialeve apo librave të veçantë.</p> <p><i>Krijoni mundësinë që fëmija të ketë shumëllojshmëri të lodrave, objekteve të sigurta, materialeve, librave në ambientin e tij/saj dhe inkurajoni iniciativën e fëmijës në zgjedhjen e disa prej lodrave.</i></p>	<p>Fëmija fillon në mënyrë të pavarur, lojën aktivitetin e ri.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të luajë vetë në ambientin e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija fillon të zgjedhë aktivitetin në të cilin dëshiron të marrë pjesë.</p> <p><i>Lejoni djalin dhe vajzën të shprehë iniciativën për zgjedhjen e lojës së tyre, dhe tregoni se si të rriturit marrin iniciativa (nisma).</i></p> <p>Fëmija jep ide për aktivitetet që dëshiron të bëjë.</p> <p><i>Nxitni fëmijën dhe stimuloni idetë e tij/saj për mënyrën se si ai/ajo do ta kalojë kohën. * Respektoni idetë e fëmijës për aktivitetet e zgjedhura.</i></p>	<p>Në mënyrë të pavarur zgjedh lodrat që i duhen për lojën e tij/saj, (kubet për të ndërtuar kullën, kukullat për të luajtur shtëpiash etj.).</p> <p><i>Siguroni fëmijës një hapësirë të mbushur me lodra apo objekte të sigurta dhe lejoni atë të shprehë interesin dhe të marrë nismë në aktivitetin e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija i kërkon shokut/shoqes të luajë me të.</p> <p><i>Inkurajoni (nxitni) dhe organizoni lojëra ku fëmija bashkëvepron me fëmijë të tjerë pa bërë dallime gjinore.</i></p> <p><i>Lejoni fëmijës të zgjedhë vetë lojën dhe shokët (shoqet e tij/saj).</i></p>	<p>Fëmija bën vetë planin e kohës të tij/saj dhe e realizon atë.</p> <p><i>Ofroni fëmijës mundësi të shumëllojshme për të bërë aktivitetet që ai/ajo ka planifikuar.</i></p>

Standardi 3 : Fëmija tregon aftësi të marrë pjesë në disa aktivitete, veprimtari dhe të këmbëngulë në të edhe kur përballlet me pengesa apo vështirësi

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija tund disa herë një lodër me zhurmë për ta dëgjuar tingullin.</p> <p><i>Ofroni fëmijës lodra të sigurta dhe luani bashkë me të.</i></p> <p>Drejton duart dhe qan derisa ta marrin në krah.</p>	<p>Fëmija fillon të kërkojë lodrën/at që nuk i sheh në mesin e lodrave të tjera.</p> <p><i>Pasurojeni ambientin e fëmijës me lodra dhe objekte të thjeshta, të përbëra, por të gjitha të sigurta.</i></p>	<p>Fëmija luan lojën e tij/saj të preferuar. Fëmija përpiqet vetë të zgjidhë një situatë.</p> <p><i>Lejoni fëmijën dhe stimuloni atë të gjejë zgjidhje në situata të ndryshme, si të bashkojë pjesë të një lodre, të ndërtojë një kullë, etj.</i></p>	<p>Fëmija provon disa herë për të mbërritur një lodër në pozitë të vështirë.</p> <p><i>Stimuloni përpjekjen e fëmijës për të kapur, të marrë lodrat që dëshiron.</i></p> <p>Fëmija kërkon ndihmë pasi të ketë provuar për një-dy minuta të bashkojë pjesët e një enigme.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën në plotësimin e enigmave, udhëzoni qartë dhe kërkon ta realizojë vetë enigmën.</i></p>	<p>Fëmija përdor dy ose më tepër rrugë, strategji për zgjidhjen e situatës, problemit, duke këmbëngulur, pavarësisht mospasjes së mëparshme.</p> <p><i>Jepini fëmijës udhëzime ose kërkonin edhe nga fëmijë të tjerë të japin sugjerime për zgjidhjen e problemit.</i></p> <p>Fëmija përfshihet në aktivitete të ndryshme për rreth 10 minuta.</p> <p><i>Nxitni fëmijën të përfundojë lojën e filluar dhe përgëzojeni për këmbënguljen e treguar.</i></p>	<p>Fëmija vazhdon aktivitetin e një dite më parë, deri në përfundimin e tij të suksesshëm (p.sh. vizatimet për ekspozitën e kopshtit, punimin me plastelinë, lulet e mbjella në pranverë etj.).</p> <p><i>Organizoni aktivitete që kërkojnë prej fëmijës të jetë i/e angazhuar në to, më shumë se një ditë, p.sh. një vizatim i pranverës mbi një fletë të madhe, mbjellja e luleve në oborr, vazhdimi i leximit të tregimit të lënë përgjysmë një ditë më parë, pastrimi për disa ditë nga gjethet i oborrit të kopshtit etj...</i></p>	<p>Fëmija vazhdon me aktivitetin e tij/saj edhe kur has në disa pengesa.</p> <p><i>Lejoni fëmijën të ketë kohën e nevojshme për të përfunduar angazhimin e tij/saj të herëpashershëm.</i></p> <p><i>Mbështetni dhe përgëzoni fëmijën në përpjekjet e tij/saj për të realizuar me sukses punën që po bën.</i></p>



Standardi 4 : Në aktivitetet e përditshme fëmijët përdorin imagjinatën e tyre dhe kreativitetin

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
	<p>Fëmija përdor lodrat në mënyra të ndryshme duke i kombinuar ato në mënyrë kreative (krijuese).</p> <p><i>Ofroni që fëmija të ketë sa me shumë objekte, lodra, dhe luani me fëmijën në mënyrë krijuese.</i></p>	<p>Fëmija përdor objektet të përditshëm në mënyrë kreative, të për të luajtur, si p.sh lugën, gotën, rrobat etj.</p> <p><i>Ofroni fëmijës objekte të jetës së përditshme (gotë, lugë, pjatë, plastike etj.) në përmasa të pranueshme dhe të përshtatshme për ta dhe lejoni t'i përdorë ato.</i></p>	<p>Fëmija imagjinon gjëra të ndryshme në lojë.</p> <p><i>Jepni shtytje lojës së fëmijës kur është duke përdorur imagjinatën e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija krijon lojëra të reja dhe aktivitete të ndryshme.</p> <p><i>Mbështetni fëmijën në krijimin e lojërave dhe aktiviteteve të tij/saj.</i></p> <p>Fëmija krijon ngjarje apo këngë në aktivitetet që bën.</p> <p><i>Krijoni fëmijës një ambient ku mund të shprehë veten dhe të eksperimentojë me idetë e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija praktikon imagjinatën në lojë dhe kombinon, përzier aktivitetet dhe lodrat në shumë mënyra.</p> <p><i>Inkurajoni fëmijën të zhvillojë lojëra të tilla.</i></p>	<p>Fëmija ndryshon tregimet e njohura duke prezantuar personazhe të krijuara prej tij/saj duke ndryshuar edhe rrjedhën e tregimit.</p> <p><i>Prezantoni fëmijës ngjarje apo tregime ku edhe ju vetë tregoni përvojat tuaja. Lexoni fëmijës tregimet tashmë të njohura dhe kërkoni prej tij/saj një tjetër përfundim apo rrjedhë ngjarjeje.</i></p>



Standardi 5 : Fëmija demonstroi aftësinë për të mësuar në mënyra të ndryshme përmes eksperiencave të tij/saj

0 – 2 vjeç			2 deri në 3 vjeç	3 deri në 4 vjeç	4 deri në 5 vjeç	5 deri në 6 vjeç
Deri në 6 muaj	6 deri në 18 muaj	18 deri në 24 muaj				
<p>Fëmija shtyp butonat e një lodre me muzikë për të dëgjuar tinguj të ndryshëm.</p> <p><i>Ofroni lodra me muzikë pas shtypjes së butonit.</i></p>	<p>Fëmija luan lojën e djeshme, por duke e ndryshuar atë.</p> <p><i>Stimuloni fëmijën të bëjë ndryshime në lojën e tij/saj, ta plotësojë atë në mënyrë tjetër apo të ndërrojë pjesë të veçanta të saj.</i></p>	<p>Fëmija fillon të dallojë që një veprim i caktuar shkakton një rezultat (p.sh. kur vendoset pjata në tavolinë është koha për të ngrënë etj.).</p> <p><i>Lejoni fëmijën t'ju shoqërojë në veprimtaritë e ditës (gjatë përgatitjes së ushqimit, ujitjes së kopshtit etj.).</i></p>	<p>Fëmija flet dhe u tregon të tjerëve se çfarë i ka ndodhur në të shkuarën.</p> <p><i>Kërkoni nga fëmijët t'ju tregojnë vetë për eksperiencat e kaluara, pa i ndërprerë dhe duke shfaqur interes për to, (vizitat te të afërmit, te mjeku, etj.).</i> <i>Bisedoni me fëmijën rreth asaj se çfarë mësoi ai nga eksperiencat e kaluara.</i></p>	<p>Fëmija mendon me zë të lartë dhe flet gjatë angazhimeve në lojë.</p> <p><i>Bëni fëmijës pyetje të qarta në mënyrë që ai/ajo të jetë në gjendje të përshkruajë çfarë bën apo mendon. (Çfarë nëse...? Si mundesh ti?)</i></p>	<p>Fëmija përdor të gjitha mënyrat për të treguar apo shprehur eksperiencën e tij/saj.</p> <p>(Tregon ngjarje, vizaton, imiton etj.).</p> <p><i>Krijoni mundësi që fëmija të përdorë mënyra të ndryshme për të treguar eksperiencën e tij/saj.</i></p>	<p>Fëmija planifikon aktivitete dhe vendos rregulla mbështetur në përvojat e mëparshme.</p> <p><i>Krijoni ambiente të përshtatshme dhe lejoni fëmijën të krijojë planifikojë dhe të zhvillojë vetë lojën e tij/saj në bazë të përvojave të mëparshme (me shumë shokë në lojë, ndryshimi i materialeve të lojës) etj.</i></p>

LITERATURA

Grup autorësh (2005): *Arti i rritjes së fëmijëve (çdo gjë që duhet të dini nga shtatzënia deri në moshën gjashtëvjeçare)*, Pegi, Tiranë

Theodhori Karaj (2005): *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*, Progres, Tiranë

Pettijon, Terry F. (1996): *Psikologjia /Një hyrje koncize/* (botimi i dytë). Fondacioni Soros “Programi për mbështetjen e Arsimit të Lartë në Shqipëri”, “Lilo” , fq. 82.

Landers, c.,(2002). *Milestones in early child development.* Developmental Pediatrics

MASHT.,(2006). *Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeç).* Libri shkollor. Prishtinë

MASHT., (2010). *Standardet e zhvillimit dhe të nxënies në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç.* DRAFT

MPPS., (2008). *Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijët në moshë prej 0-6 vjeç.* Republika e Maqedonisë. KOMA

Ross Vasta, Marshall M.Haith dhe Scott A.Miller (2007): *Psikologjia e fëmijës – shkenca moderne*, Uegen, Tiranë

Spodek, B., & Saracho, O., (1994). *Right from the start: Teaching children age’s three to eight.* Boston: Allyn and Bacon

Sharon.L.Kagan, Pia Rebello Britto(2005). *Going global with Early Learning and Development Standards.* Columbia University

Shonkoff, J.P., & Phillips, D.A. (Eds.) (2000). *From neurons to neighborhoods: The science of early childhood development.* Washington, DC: National Academy Press

Unicef LIFESTART, (2001). *UNICEF , Early Childhood Resource Pack, Young child Survival, Growth&Development*

World Bank, (2002). *From Early Child Development to Human Development .* Washington DC

Washington State Early Learning and Development Benchmarks., (2005). *A guide to Young Children’s Learning and Development: From birth to kindergarten entry,* Tha State of Washington.



Autorët e dokumentit.

Merita Shala	Këshilltare profesionale e dokumentit. Profesor asistente. Eksperte e fushës së zhvillimit fizik dhe lëvizor.
Labëri Luzha	Zyrtare e arsimit parashkollor - MASHT
Ardita Kajtazi	Pedagoge. Ish-zyrtare e arsimit parashkollor - MASHT
Mimoza Shahini	Psikiatre. Eksperte e fushës së zhvillimit njohës dhe njohurive të përgjithshme.
Arlinda Beka	Pedagoge. Eksperte e fushës së zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit. Asistente në Fakultetin e Edukimit. U.P.
Teuta Danuza	Psikologe. Eksperte e fushës së zhvillimit social-emocional. Asistente në Fakultetin e Edukimit. U.P.
Eda Vula	Profesor Asistente. Eksperte e fushës së Matematikës. Fakulteti i Edukimit. U.P.
Besa Luzha	Eksperte e edukimit muzikor. Fakulteti i Arteve. U.P.
Remzije Krasniqi	Pedagoge. Eksperte për edukim gjithëpërfshirës. Drejtoreshë e kopshtit S.O.S . Prishtinë.
Haki Xhakli	Ekspert i fushës së zhvillimit të artit. Fakulteti i Edukimit. U.P.
Fetah Bylykbashi	Ish-udhëheqës i arsimit parashkollor në MASHT
Afërdita Spahiu	Eksperte e edukimit – Zyra e UNICEF-it për Kosovë
Kozeta Imami	Zyrtare për edukimin e hershëm - Zyra e UNICEF-it për Kosovë

Anëtarët e grupit punues gjatë procesit të validimit të përmbajtjes:

Alush Istogu	Drejtor i Administratës në MASHT
Ramush Lekaj	Udhëheqës i zyrës së programeve në MASHT
Muharrem Asllani	Psikiatër i fëmijëve
Selim Mehmeti	Pedagog
Vlora Ismaili-Jaha	Mjeke pediatre.
Driton Bajraktari	Prind
Drita Curri	Drejtoreshë në shkollë fillore.
Elife Maxhuni	Edukatore parashkollore

Grupi punues gjatë procesit të validimit të moshës:

Nezir Çoçaj	Pedagog. Këshilltar për arsimin parauniversitar në Ministrinë e Arsimit.
Miranda Kasneci	Gjuhëtare
Mimoza Shahini	Psikiatre e fëmijëve
Drita Qosaj	Mjeke pediatre
Selim Mehmeti	Pedagog
Luljeta Kurhasani	Prind
Fitnete Berisha	Edukatore me grupet parashkollore
Kadire Preniqi	Edukatore me grupin parafillor (5-6 vjeç)

Këshilltare vendore dhe ndërkombëtare të dokumentit:

Merita Shala, Dr.sc.	Qendra për Edukim Cilësor - Prishtinë, Kosovë
Sharon Lynn Kagan Ed.D	Teachers College, Columbia University. USA Child Study Center, Yale University. USA
Pia Rebello Britto, Ph.D	Child Study Center, Yale University. USA
Nadica Janeva, Dr.	Instituti për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Shkup. Maqedoni
Lena Damovska, Ph.D.	Fakulteti Filozofik. Instituti i Pedagogjisë. Universiteti Shtetëror. Shkup. Maqedoni

Mbështetës financiar dhe profesional i dokumentit**UNICEF**

Përveç anëtarëve të grupeve punuese, dokumentit i kanë kontribuar mjekë psikiatër të fëmijëve, psikologë, mjekë pediatër të institucioneve parashkollore, pediatër neonatë, motra medicinale të shëndetit mendor, fiziatër, ekspertë të kurrikulave, ekspertë të programit Hap pas Hapi, pedagogë, sociologë, prindër të fëmijëve 0-6 vjeçarë, motra edukatore, edukatore parashkollore, drejtoresha të institucioneve parashkollore. Një ndihmesë të madhe kanë ofruar Fekrije Hasani dhe Niman Bardhi nga Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

159.922.73

372.3

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet / Përgatiten Merita Shala...[et al.] - Prishtinë : Ministria e Arsimit, Shencës dhe Teknologjisë, 2011. - 84 f. : ilustr. me ngjyra ; 29 cm.

Parathënie / Ramë Buja : f. 4. - Literatura : f. 80

1. Shala, Merita

ISBN 978-9951-16-042-1



Përkrahur nga UNICEF, Zyra në Kosovë

ISBN 978-9951-16-042-1



9 789951 160421